

KËRKIMI



REVISTA E STATISTIKAVE DHE
ANALIZAVE SOCIAL-EKONOMIKE

5

KËRKIMI

REVISTA E STATISTIKAVE DHE ANALIZAVE SOCIAL-EKONOMIKE
INSTAT

EDITORËT

DREJTOR BOTIMI

Dr. Elsa Dhuli, Instituti i Statistikave

BORDI EDITORIAL

1. Helda Curma, Instituti i Statistikave
2. Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave
3. Alma Kondi, Instituti i Statistikave
4. Blerina Subashi, IDRA
5. Ermir Lico, Instituti i Statistikave
6. Alban Çela, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
7. Majlinda Nesturi, Instituti i Statistikave
8. Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave
9. Eriola Gjika, Instituti i Statistikave

BORDI KËSHILLIMOR

1. Dr. Delina Ibrahimaj, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
2. Prof. Dr. Bukurie Dumani, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik
3. Prof. Asoc. Dr. Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës
4. Dr. Erion Luçi, KfW (Banka Gjermane e Zhvillimit) dhe Banka Botërore
5. Dr. Erka Caro, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
6. Dr. Evelina Çeliku, Banka e Shqipërisë
7. Prof. Asoc. Gianluca Mattarocci, Universiteti i Romës Tor Vergata
8. Dr. Sebastian Schief, Universiteti i Fribourg, Departmenti i Shkencave Sociale
9. Daniela Muhaj, Research Fellow at Growth Lab, Harvard University
10. Dr. Ljubica Nedelkoska, Postdoctoral Fellow at Growth Lab, Harvard University
11. Prof. Dan Hedlin, Universiteti i Stokholmit
12. Prof. Michael Carlson, Universiteti i Stokholmit

Redaktor letrar: Enkelejt Avdyli

ISSN: 2664-1380

Copyright INSTAT 2021

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

*Pikëpamjet e shprehura në këtë revistë janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Institutit të Statistikave.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

e-mail: Revistakerkimi@instat.gov.al

Tel: +(355) 42222411

PËRMBAJTJA

ARTIKUJ SHKENCORË

- 5. PËRVOJA SHQIPTARE NË MATJEN DHE VLERËSIMIN E INDEKSIT TË PRIVIMIT MATERIAL TË FËMIJËVE**
Majlinda Nesturi, Instituti i Statistikave
Blerta Muja, Instituti i Statistikave
- 18. ASPEKTET E CILËSISË SË EDITIMIT DHE IMPUTIMIT PËR ANKETËN E BUXHETIT TË FAMILJES NË SHQIPËRI**
Alma Kondi, Instituti i Statistikave
Anisa Omuri, Instituti i Statistikave
Dan Hedlin, Universiteti i Stokholmit
- 29. ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJET SHQIPTARE**
Irsida Nuellari, Instituti i Statistikave
Ermira Palushi, Instituti i Statistikave
Michael Carlson, Universiteti i Stokholmit
- 41. RASTI I NDËRTIMIT NË SHQIPËRI: LIDHJA ME SEKTORË TË TJERË DHE NDIKIMI NË PBB**
Stejsi Mici, Instituti i Statistikave
- 60. IMPAKTI SOCIAL DHE EKONOMIK I FENOMENIT TË 'IKJES SË TRURIT' NË VENDET NË ZHVILLIM**
Elma Çali, Instituti i Statistikave
Sokrat Palushi, Instituti i Statistikave
- 69. NON-RESPONSE ADJUSTMENT AND REVISION OF TIME SERIES IN WASTE STATISTICS**
Jovana Mihailovic, Statistical Office of Montenegro – MONSTAT
- 72. TRANSFORMIMI I FORMËS URBANE DHE GIS, QYTETI I TIRANËS**
Andi Shameti, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanizmit

I dashur Lexues,

Instituti i Statistikave vjen këtë herë pranë jush me numrin e pestë të revistës “KËRKIMI”, për të gjithë përdoruesit të cilët janë të interesuar të njihen me të rejat më të fundit në botën e shkencës së statistikave. Metodat e reja statistikore dhe përdorimi i tyre në studimin e fenomeneve të veçanta, lidhja me fushat social-ekonomike, apo impakti i tyre në shoqëri, prezantohen në artikujt e numrit të pestë të kësaj reviste.

Revista KËRKIMI vjen me një risi, pasi përmban vetëm artikuj shkencorë, duke respektuar rregullat dhe procedurat e një studimi shkencor. Artikujt informues janë pjesë e Revistës INFOSTAT, e cila vjen pranë jush me artikuj analitik, dhe informon mbi zhvillimet më të fundit metodologjike nëpërmjet historive statistikore.

Artikujt e Revistës Kërkimi, përveç dimensionit shkencor kanë edhe rol edukues e kulturor. Ato kontribuojnë në zhvillimin social ekonomik të një vendi dhe perspektivën për të ardhmen. INSTAT, me qëllim që të forcojë këtë rol në fushën e statistikave, të promovojë metodat dhe modelet e reja shkencore në këtë fushë, por të rrisë edhe besimin e përdoruesve në statistika, dhe përdorimin e tyre në mënyrë sa më të drejtë, prezanton 7 artikuj në këtë numër të Revistës KËRKIMI.

Nëpërmjet këtyre artikujve INSTAT kërkon të përcjellë tek lexuesi mesazhin kryesor mbi rolin e rëndësishëm të statistikave, si gjuha me të cilën matet progresi ekonomik, shoqëror, demografik, mjedisor i një vendi. Metodat apo modelet e reja shkencore të shprehura nga autorët në këtë numër reviste, janë bashkëkohore dhe mund të na çojnë në të ardhmen në përfundime më të sakta, të besueshme dhe të qëndrueshme në kohë.

Si prodhues dhe koordinues i sistemit statistikor, INSTAT do të vazhdojë rregullisht publikimin e artikujve shkencorë në fushën e statistikave, dhe jo vetëm, si dhe do të ndihmojë në përdorimin e statistikave në shkallë të gjerë edhe në fusha të tjera, duke i bërë ato më të lexueshme dhe më të kuptueshme për përdoruesit. Roli i INSTAT është jo vetëm të prodhojë statistika, por edhe të promovojë metodat e reja shkencore bashkëkohore në fushën e statistikave, të rrisë vlerat e statistikave dhe të promovojë kulturën statistikore në vend, duke i ofruar kërkuesve mundësi për të shprehur zërin e tyre edhe në komunitetin ndërkombëtar statistikor.

Revista publikohet me frekuencë vjetore dhe i shërbehet përdoruesve dhe publikut të gjerë në versionin online, në faqen Zyrtare të INSTAT, [www.instat.gov.al/Revista Kërkimi](http://www.instat.gov.al/Revista_Kerkimi). Nëpërmjet kësaj reviste, kërkojmë të tërheqim jo vetëm një masë të konsiderueshme lexuesish, por edhe shkrues të cilët kanë interesin të bëhen pjesë e rrjetit të shkencës së statistikave. INSTAT mirëpret artikujt shkencorë që kontribuojnë me studime shkencore në fusha socio-ekonomike, metoda dhe modele të reja statistikore, matja e impaktit të tyre në shoqëri, në vend dhe rajon, studime shkencore të dedikuara për rajonin, si dhe trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët në fushën e ekonomisë, shoqërisë dhe në veçanti të integritetit në Bashkimin Evropian.

Në mënyrë që të rritet dhe forcohet roli i kësaj shkence, të përmirësohet në vazhdimësi dhe të ketë një vend në të ardhmen edhe në komunitetin ndërkombëtar, Bordi Editorial i revistës fton statisticienë, zyrtarë, akademikë, analistë, politikëbërës dhe në përgjithësi çdo palë të interesuar, të bëhen pjesë e saj, për mënyrën në të cilën të menduarit statistikor, metodat dhe modelet e reja shkencore, ndikojnë në vendimet që prekin aspektet e ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë.

Gjej rasti të falenderoj të gjithë ata autor apo bashkëautor, kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në këtë revistë!

Përzemërsisht,

Dr. Elsa DHULI,
Drejtor i Përgjithshëm, Instituti i Statistikave

PËRVOJA SHQIPTARE NË MATJEN DHE VLERËSIMIN E INDEKSIT TË PRIVIMIT MATERIAL TË FËMIJËVE

Majlinda Nesturi, Instituti i Statistikave
mnesturi@instat.gov.al

Blerta Muja, Instituti i Statistikave
bmuja@instat.gov.al

Abstrakt

Varfëria monetare e familjes jep informacion të rëndësishëm për të kuptuar gjendjen e fëmijëve aty ku jetojnë, por kjo nuk është e mjaftueshme. Mirëqenien e fëmijëve e prekin edhe përmasa të tjera përveç varfërisë së të ardhurave. Varfëri e fëmijëve do të thotë privim, jo vetëm për sa i përket pamundësisë për të mirat dhe nevojat themelore, por edhe lidhur me mundësitë për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri dhe në edukim.

Ky studim propozon hapa të reja që ndihmojnë në matjen dhe vlerësimin e privimit material dhe social të fëmijëve në Shqipëri, duke u bazuar në përvojën e Bashkimit Evropian dhe kornizën metodologjike të hartuar nga Guio et al. (2012, 2017). Zhvillimi i këtij studimi është ndihmuar nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet INSTAT-it dhe UNICEF-it.

Për studimin e zërave të privimit material të fëmijëve është përdorur Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (EU-SILC).

Në vitin 2018, pyetësi EU-SILC për Shqipërinë përfshiu një modul ad-hoc për zërat e privimit material dedikuar vetëm për fëmijët.

Këto të dhëna ndihmojnë për zhvillimin e hapave që duhet të ndiqen për validimin e zërave të privimit të fëmijëve.

Në këtë studim, janë marrë parasysh katër aspekte për vlerësimin e listës së zërave të privimit material: Përshtatshmëria, Vlefshmëria, Besueshmëria dhe Aditiviteti i të dhënave.

Fjalë kyçe:

Privimi i fëmijëve, Varfëria, Të Ardhurat dhe Niveli i Jetesës, Pamundësia Financiare

1. HYRJE

“Vlerësimi i vërtetë i gjendjes së një kombi është masa e përkujdesjes ndaj fëmijëve – shëndetin dhe sigurinë e tyre, sigurinë e tyre materiale, arsimimin dhe shoqërizimin, dhe të ndihen të dashur, të vlerësuar dhe të përfshirë në familjet dhe shoqëritë në të cilat janë pjesë.” – UNICEF 2007.

Konceptet e varfërisë relative lidhur me të ardhurat, thellësisë së privimit material (varfëria jo-monetare), si edhe të numrit të njerëzve që janë në rrezik për të qenë të varfër ose përjashtimi social (AROPE) janë nga më të përdorurat në vendet e BE-së. Dhe duke filluar nga viti 2017 dhe në vazhdim, po të njëjtat koncepte dhe metodologji po zbatohen edhe në Shqipëri.

Burimi kryesor i informacionit për varfërinë relative në vendet e BE-së dhe në Shqipëri është anketa mbi të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës (EU-SILC). Ky vërtetim është tërësisht në përputhje me metodologjinë Eurostat të përdorur nga të gjitha shtetet e tjera anëtare të BE-së.

Përveç varfërisë monetare dhe jo-monetare të të gjithë popullatës, varfëria e fëmijëve është një nga problemet më madhore në vend që duhet trajtuar.

Shqyrtimi i familjeve me varfëri monetare nuk mjafton për të monitoruar prirjet e varfërisë së fëmijëve. Ka fëmijë që jetojnë në familje jo të varfra të cilët përballen me kategori të privimit material, gjë që dëshmon nevojën për matje të bazuara tek fëmijët.

Privimi material i fëmijëve zakonisht ndikon negativisht në arritjet e tyre arsimore dhe në zhvillimin social. Për këtë arsye, nevoja për prodhimin e statistikave që shkojnë përtej matjes së të ardhurave, është një detyrë e rëndësishme për t’u zbatuar. Statistika të tilla ndihmojnë matjen dhe monitorimin e niveleve të varfërisë së fëmijëve si dhe hartimin e politikave sociale që i ndihmojnë fëmijët.

Edhe pse shumë prej zërave të privimit material të familjeve që gjenden në pyetësorin bazë të EU-SILC vlejnë për gjendjen e fëmijëve, matja e duhur e kushteve të jetesës së fëmijëve kërkon mbledhjen e një informacioni më specifik lidhur me nevojat e fëmijëve. Disponueshmëria e të dhënave të EU-SILC për tregues specifik për fëmijët ndihmon për ndërtimin e analizave lidhur me privime specifike të fëmijëve.

Një listë e kombinuar zërash të privimit material që prekin fëmijët si dhe familjet e tyre, do të ndihmojë për zhvillimin

e Indeksit të Privimit Material të Fëmijëve.

Mbledhja e të dhënave dhe përlllogaritja e treguesve bazuar në një metodologji të caktuar nuk mjafton. Së pari, është i rëndësishëm validimi i të gjithë zërave të privimit material që duhet të përdoren për matjen e indeksit të privimit të fëmijëve.

Për këtë arsye, është kryer një testim i të dhënave të EU-SILC 2018 për të ndjekur rregullat dhe metodologjinë e Guio et al. 2012 për validimin e zërave të privimit material.

Në të ardhmen e afërt, me të dhënat e EU-SILC 2019 dhe disa ndryshime të vogla në çështjet metodologjike, do të ndiqen të njëjtat rregulla për zbatimin për herë të parë në Shqipëri të përlllogaritjes së Indeksit të Privimit të Fëmijëve.

Objekti i këtij studimi është testimi dhe marrja në shqyrtim e karakteristikave që ndihmojnë në validimin e të dhënave të nevojshme për krijimin e Indeksit të Privimit të Fëmijëve. Katër karakteristikat që do të ndiqen për procesin e miratimit të të dhënave janë Përshtatshmëria, Vlefshmëria, Besueshmëria dhe Aditiviteti i të dhënave.

Hapat e zbatuar në këtë studim për përlllogaritjen e Indeksit të Privimit të Fëmijëve do të ndihmojnë për përcaktimin e një strukture të duhur që duhet të ndiqet për validimin e procesit të të dhënave dhe për përlllogaritjen e Indeksit të Privimit të Fëmijëve për të parën herë në Shqipëri, duke përdorur metodologjinë e vendeve të BE-së. Mirëpo, përdorimi i metodologjisë së vendeve të BE-së është i rëndësishëm për testimin e të gjithë zërave që ndihmojnë në njehësimin e indeksit për të parë nëse të dhënat e Shqipërisë janë mbledhur në mënyrën e duhur dhe a janë të vlefshme për t’u përfshirë në përlllogaritjen e indeksit.

Në pjesën e parë të këtij studimi shpjegohet përvoja dhe metodologjitë e përdorura nga vendet e tjera për zbatimin e Indeksit të Privimit të Fëmijëve. Më tej, shpjegohet metodologjia e përdorur për zbatimin e procesit të validimit që nevojitet për njehësimin e Indeksit të Privimit të Fëmijëve. Të katër testimet, Përshtatshmëria, Vlefshmëria, Besueshmëria dhe Aditiviteti i të dhënave të ndjekura nga ky studim, në pjesën e analizës, do të ndihmojnë për përzgjedhjen e zërave të nevojshëm që do të ndihmojnë në përmirësimin e Indeksit të Privimit të Fëmijëve. Në fund të këtij studimi, shpjegohen disa përfundime dhe rekomandime që lidhen me njehësimin e indeksit dhe mundësinë e vendosjes së kufijve të mundshëm që ndihmojnë në përcaktimin e Indeksit të Privimit të Fëmijëve.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pjesë e të cilave u bënë të gjitha qeveritë e vendeve anëtare të OKB-së në vitin 2015, bëjnë thirrje për t'i dhënë fund varfërisë kudo në të gjitha format e saj. Objektivi 1.2 bën fjalë për t'i dhënë fund varfërisë sipas përcaktimeve kombëtare deri në vitin 2030. Kjo do të thotë se matja e progresit drejt objektivit 1.2 kërkon përcaktimin e një kufiri bazë për vlerësimin e varfërisë. Burimi i të dhënave për varfërinë e të ardhurave në vendet e BE-së dhe në Shqipëri, duke filluar që nga viti 2017, është anketa mbi të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës (EU-SILC).

Varfëria e fëmijëve në vendet e BE-së dhe së fundmi, në Shqipëri, matet tradicionalisht për grupin e fëmijëve të moshës 0-17 vjeç, që jetojnë në familjet e përcaktuara si në rrezik për të qenë të varfër. Vëzhgimi i familjeve me varfëri monetare nuk mjafton për të monitoruar prirjet e varfërisë së fëmijëve, pasi fëmijët e përjetojnë varfërinë ndryshe nga të rriturit që jetojnë në të njëjtën familje.

UNICEF ka luajtur një rol madhor në përparimin e çështjes së varfërisë së fëmijëve dhe mirëqenies sipas axhendës sociale globale (UNICEF 2012). Si pjesë të kësaj teme, UNICEF-i ka mobilizuar aktorë në nivele kombëtare, rajonale dhe globale për t'i ndihmuar vendet të masin dhe trajtojnë varfërinë e fëmijëve në të gjitha format e saj.

Roli i Bashkimit Evropian (BE) për këtë fushë është gjithashtu i rëndësishëm. Vite më parë, në mungesë të një treguesi të veçantë për privimin e fëmijëve, treguesi zyrtar i BE-së për fëmijët ishte grupi i fëmijëve që jetonin në familjet e privuara. Privimi material është matur si pamundësia financiare e familjeve për të përballuar të paktën tre nga nëntë zërat e Privimit Material, duke përdorur të dhënat e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës: 1) përballimi i shpenzimeve të papritura; 2) përballimi i një pushimi vjetor një javor jashtë shtëpisë; 3) shlyerja e pagesave të prapambetura; 4) ngrënia e një vakti me mish, pulë ose peshk çdo dy ditë; 5) ngrohja e shtëpisë në mënyrë të përshtatshme; 6) pasja e një rrobalesë; 7) pasja e një televizori me ngjyra; 8) pasja e një telefoni; 9) pasja e një makine personale (Yekaterina Chzhen, Chris de Neubourg, Ilze Plavgo & Marlous de Milliano, 2015). Është gjerësisht e pranuar se varfëria monetare dhe materiale e fëmijëve nevojitet të studiohet më tepër në nivel individual sesa në atë familjar (Chzhen and Bradshaw 2012; De Neubourg et al. 2012a; Guio et al. 2012; Main and Bradshaw 2012).

Privimi i fëmijëve dhe marrëdhënia e tij me varfërinë monetare të fëmijëve në Bashkimin Evropian (BE), duke përdorur metodologjinë e Analizës së Mbivendosjes së Shumëfishtë të Privimit (MODA) (De Neubourg et al. 2012c) është zbatuar disa vjet më parë në disa vende të BE-së. Kështu, ky tregues ndihmon për identifikimin e fëmijëve që vuajnë njëkohësisht nga privime të ndryshme.

Në të njëjtën kohë, Guio et al. (2012) i kanë propozuar BE-së treguesin e tyre të privimit material. Ata kanë advokuar për marrjen e dy masave të veçanta, njëra për të gjithë popullsinë dhe tjetra për fëmijët e moshës 1-15 vjeç. Çdo zë i përfshirë në këta tregues është testuar dhe e ka kaluar procesin e validimit për Përshtatshmërinë (pra, u desh që të perceptohej si i nevojshëm për një standard të pranueshëm jetese në një vend të caktuar) dhe për Vlefshmërinë (d.m.th. duhej të bashkëlidhej në mënyrë domethënëse me parashikuesit e pavarur të privimit material). Shkalla e përbërë vlerësuese që doli nga kjo, duhej të ishte në vetvete konsistente dhe aditive. Këto kritere prodhuan një tregues që përmbante 13 zëra për gjithë popullsinë dhe një tregues me 18 zëra për fëmijët. 18 zërat përbëheshin nga 5 zëra në nivel familje dhe 13 zëra të veçantë për fëmijët. Vendet evropiane, në vitin 2009 dhe 2014, zbatuan modulet ad-hoc të EU-SILC për privimin duke përfshirë dhe zëra të veçantë që lidhen me fëmijët, duke mundësuar kështu zhvillimin e indeksit të veçantë të Privimit Material dhe Social për fëmijët, me të dhëna nga EU-SILC 2014 (Guio et al. 2012). Vendet e BE-së vendosën një prag të veçantë; një kufi prej tre ose më shumë zërash nga 18 të tillë prodhuan një shkallë privimi të fëmijëve të ngjashme me atë që bazohet në treguesin standard të BE-së për privimin material.

Për të parën herë, Shqipëria, në bashkëpunim me UNICEF-in, po bën përpjekje për zhvillimin e Indeksit të Privimit Material të fëmijëve dhe në të ardhmen ky tregues do të jetë përfaqësues dhe i disponueshëm për Shqipërinë. Metodologjia e përdorur për njehësimin e këtij indeksi është bazuar te metodologjia Guio et al. (2012) dhe janë ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm për validimin e çdo kategorie që ndihmon për matjen e Indeksit të Privimit të Fëmijëve.

3. METODOLOGJIA

Me qëllim vlerësimin e vlefshmërisë së zërave të privimit material në nivelet e fëmijëve dhe familjeve që ndihmojnë në përlogaritjen e Indeksit të Privimit të Fëmijëve, ky studim përdor Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, EU-SILC 2018, të realizuar nga Instituti i Statistikave në Shqipëri. Në vitin 2018, anketa u krye duke anketuar 6.630 familje dhe për këto studime u përzgjedhën vetëm familjet me fëmijë të moshës 0-15 vjeç.

Informacioni i mbledhur nga kjo anketë përfshin informacione lidhur me shpërndarjen e të ardhurave të familjes, shëndetit dhe paaftësisë, punësimit dhe privimit material. Në këtë kontekst, treguesit e dalë nga SILC kanë për qëllim identifikimin e kategorive të popullsisë që janë më të privuara për t'u prekur nga varfëria dhe privimi material.

Metoda e përdorur për SILC përfshin intervista personale nga një kampion përfaqësues familjesh dhe personash që jetojnë në këto familje në kohën e mbledhjes së të dhënave. Për mbledhjen e të dhënave, është përdorur sistemi CAPI.

Ky vërtetim është përfaqësues në rang vendi dhe është tërësisht në përputhje me metodologjinë Eurostat. EU-SILC është burimi bazë për statistikën e krahasueshme mbi shpërndarjen e të ardhurave dhe përjashtimin social në nivel evropian. Anketa e rregullt EU-SILC mbledh informacion çdo vit për privimin material dhe social të familjeve në pyetjet kryesore (core) të saj. Mirëpo, për përmirësimin e Indeksit të Privimit Material dhe social të fëmijëve, INSTAT-i po përdor, si një modul ad-hoc, disa pyetje të reja specifike mbi privimin material dhe social të fëmijëve.

Metodologjia e përdorur për shtimin e këtyre zërave të posaçëm bazohet në rregulloret e Eurostat-it meqenëse Bashkimi Evropian ka mbledhur dy herë informacion lidhur me privimin material dhe social të fëmijëve në veçanti, në vitet 2009 dhe 2014 (Eurostat, 2008 dhe 2013).

Zërat për fëmijët u pyetën në nivel familje dhe u morën përgjigje nga të anketuarit e familjeve për të gjithë fëmijët anëtarë të asaj familje, nën 16 vjeç. Në këtë grup pyetjesh është vlerësuar mundësia financiare e familjes për përmbushjen e nevojave të mëposhtme të fëmijëve. Nëse të paktën një fëmijë nuk e ka zërin përkatës, i gjithë grupi i fëmijëve në familje hamendësohet se nuk e ka atë zë. Të dhënat janë analizuar në nivel familje që do të thotë se analiza e të dhënave është realizuar për familjet të cilët

kanë fëmijë më të vegjël se 16 vjeç.

Zërat e veçantë për fëmijët të mbledhur janë:

1. Kanë disa rroba të reja (jo të përdorura);
2. Kanë dy palë këpucë të përshtatshme (ku futen një palë këpucë për çdo kohë);
3. Hanë fruta dhe perime një herë në ditë;
4. Hanë një vakt mish, pulë ose peshk (ose ekuivalentin për vegjetarianët) të paktën një herë në ditë;
5. Kanë në shtëpi libra të përshtatshëm për moshën e tyre;
6. Kanë pajisje argëtimi për jashtë shtëpisë (biçikletë, patina, etj.);
7. Kanë lojëra për brenda shtëpisë (lodra edukuese për foshnje, kuba ndërtues, lojëra tavoline, lojëra kompjuterike, etj.);
8. Kanë një vend të përshtatshëm për të studiuar ose për të bërë detyrat e shtëpisë;
9. Marrin pjesë në një veprimtari të rregullt argëtuese (not, i bien një vegle muzikore, organizatë rinore, etj.);
10. Kanë festime në raste të veçanta (ditëlindje, ditë emri, ngjarje fetare);
11. Ftojnë miq në shtëpi për të luajtur ose për të ngrënë herë pas here;
12. Marrin pjesë në udhëtime dhe organizime shkollore me pagesë;
13. Shkojnë për pushime larg shtëpisë të paktën një javë për çdo vit, që përfshin qëndrimin në një vend tjetër ose te miqtë/të afërmit.

Zërat e veçantë për fëmijët në SILC janë variablat kryesore që duhet të përdoren për matjen e privimit material të fëmijëve. Këta zëra nuk duhet të përdoren dhe të analizohen veçmas, por duhet të kombinohen me pyetje të tjera të SILC-ut që lidhen me privimin material të familjeve. Veçanërisht 5 zëra në nivel familje janë marrë në shqyrtim për prodhimin e Indeksit të Privimit Material të fëmijëve (EUROSTAT, 2019):

1. Vonesat në pagesat e kësteve të kredisë ose qirasë, në faturat e shërbimeve, blerjet me këste ose hua të tjera.
2. Ngrohja e shtëpisë në mënyrë të përshtatshme.
3. Akses në një makinë për përdorim privat.
4. Zëvendësim i mobilieve të vjetra.
5. Akses në internet.

Për të hartuar Indeksin e Privimit Material të fëmijëve në Shqipëri është marrë në konsideratë metodologjia e përdorur nga Guio et al (2012, 2017) ku janë bërë disa analiza të zgjeruara duke përfshirë testet e Përshtatshmërisë, Vlefshmërisë, Besueshmërisë dhe Aditivitetit. Të 18 zërat e privimit material janë testuar duke përdorur këto katër aspekte të analizës së të dhënave dhe kanë ndihmuar në përzgjedhjen e listës përfundimtare të zërave të privimit material, të cilët do të jenë baza për përllogaritjen e Indeksit të Privimit Material të fëmijëve.

4. REZULTATET

Në këtë pjesë të artikullit, sigurohet zbatimi i testeve të Përshtatshmërisë, Vlefshmërisë, Besueshmërisë dhe Aditivitetit të të dhënave të SILC 2018 në Shqipëri duke siguruar një listë përfundimtare të zërave për treguesin e fëmijëve.

4.1 Testi i përshtatshmërisë

Zërat e veçantë për fëmijët perceptohen si domosdoshmëri dhe kjo përcaktohet duke u bazuar në grupin e të anketuarve që ose e kanë një zë ose nuk e kanë atë për shkak se nuk mund ta përballojnë (kufiri i saj është caktuar në 70%) (Guio et al. 2012, 2017).


Për zërat e fëmijëve janë përdorur tre kategori përgjigjesh (përveç zërit që ka të bëjë me vendin e përshtatshëm për bërjen e detyrave të shtëpisë):

- E kanë zërin;
- Nuk e kanë zërin, pasi nuk e përballojnë dot;
- Nuk e kanë zërin për çdo lloj arsyeje tjetër.

Familjet me fëmijë që e “duan” zërin janë familje që e kanë zërin/do të donin ta kishin por nuk e përballojnë dot. Nga ana tjetër, familjet me fëmijë që “nuk e duan” zërin, janë ato që nuk e kanë atë zë për arsye të tjera dhe jo për shkak të pamundësisë financiare. Për zërat PMS të fëmijëve (me privim material dhe social), përpjesëtimi i familjeve me fëmijë që e duan secilin zë është i lartë (Shih grafiku 1). Kjo duket jo vetëm për zërat bazë (ushqim, veshje dhe këpucë), por edhe për zërat e tjerë si festime, pushime, lojëra brenda shtëpisë, pajisje argëtimi jashtë shtëpisë, etj.

Zërat me përqindjen më të madhe të “nuk duan/nuk kanë nevojë” për arsye të tjera janë “Libra të përshtatshme për moshën e tyre”, “Marrin pjesë në veprimtari argëtuese” dhe “Marrin pjesë në udhëtime dhe ngjarje shkollore me pagesë”. Meqë përqindja e secilit zë, ku shpjegohet se familjet e kanë ose nuk e kanë atë për shkak se nuk e përballojnë dot, është më e lartë se 70%, atëherë të gjithë zërat e kalojnë testin e parë.

Grafiku 1: Familje me fëmijë që “nuk e duan/nuk e kanë nevojë” ose “e duan/ e kanë nevojë” secilin prej zërave



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, EU-SILC 2018

4.2 Testi i vlefshmërisë

Hapi i dytë që ndiqet është vlefshmëria e të dhënave. Një zë i PMS (me privim material dhe social) mund të merret si i vlefshëm nëse paraqet lidhje domethënëse statistikore me një set variablash që ndërlidhen me zërat e privimit material (Guio et al. 2012, 2017). Kjo është testuar duke kryer regresione logjistike binare për secilin nga 18 zërat MPS, të emërtuar si variabla të varura kundrejt disa variablave të përzgjedhura të pavarura që dihet se kanë lidhje me krijimin e privimit. Tre tregues vlefshmërie, që janë përdorur si variabla të pavarura, janë:

- Rreziku për të qenë i varfër bazuar në të ardhurat;
- Varfëria subjektive (“vështirësi të mëdha” ose “vështirësi” për të mbuluar nevojat bazë të familjes);
- Familje thellësisht të privuara materialisht.

Çdo zë i PMS duhet të ketë një korrelacion domethënës statistikor me të paktën 2 nga 3 prej këtyre treguesve të lartpërmendur. Konsiderohet problem vlefshmërie të secilit zë të privimit material të fëmijëve kur raporti ODDS i regresionit logjistik për të paktën dy prej tre variablave (thellësia e privimit material, rreziku për të qenë i varfër dhe mundësia për të mbuluar nevojat bazë) nuk kanë lidhje statistikore me secilin prej zërave të PMS (Guio et al (2012, 2017).

Të tre variablat e pavarur janë binare (jo të vazhdueshme). Vlera 0 do të thotë se nuk është në rrezik për të qenë i varfër/thellësisht i privuar materialisht/vështirësi financiare për të mbuluar shpenzimet bazë. Vlera 1: do të thotë se është në rrezik për të qenë i varfër/thellësisht i privuar materialisht /vështirësi financiare për të mbuluar shpenzimet bazë. Për secilin prej 18 zërave PMS, janë analizuar vlera p, raporti ODDS (OR) dhe intervali i besueshmërisë 95% (Shih Tab.1). Një raport ODDS (OR) pozitiv nuk do të thotë se kemi një rezultat domethënës statistikor. Në hapin e parë kontrollon vlera p për secilin zë. Ajo është nën 0,05, duke treguar kështu një lidhje domethënëse statistikore midis variablave. Pastaj mund ta shprehim me siguri raportin ODDS. Kur raporti ODDS është më i madh se 1, atëherë përshkruan një marrëdhënie pozitive mes variablave.

Tabela 1 përmbledh rezultatet e testit të vlefshmërisë për zërat PMS (privimi material dhe social).

Zëri i pamundësisë financiare për ta ngrohur shtëpinë në mënyrë të përshtatshme ka një marrëdhënie negative me rrezikun për të qenë të varfër, pasi raporti ODDS është më

i vogël se 1, por kur ky variabël PMS e ka kaluar testin e vlefshmërisë me dy variablat e tjera të pavarura, thellësia e privimit material dhe pamundësia për të mbuluar nevojat bazë, raporti ODDS është më i madh se 1.

Zëri i vonesës në kryerjen e pagesave të kësteve të kredisë për shtëpinë, pagesës së qirasë, faturave të shërbimeve ose huave të tjera ka një marrëdhënie negative me zërin e mbulimit të nevojave bazë me vështirësi/vështirësi të madhe, raporti ODDS është nën 1, por kur ky variabël PMS e ka kaluar testin e vlefshmërisë me dy variabla të tjera të pavarura – rreziku për të qenë i varfër dhe thellësia e privimit material, raporti ODDS është mbi 1.

Secili prej zërave PMS (privim material dhe social) e ka kaluar testin e vlefshmërisë. Nuk ka pasur asnjë problem vlefshmërie, pasi secili prej tyre është domethënës nga ana statistikore me të paktën dy prej tre variablave të pavarura.

Tabela 1: Rezultatet e regresionit logjistik binar të përdorur për 18 zërat PMS (privim material dhe social) bazuar në tre variabellet e pavarura (rreziku për të qenë i varfër, thellësia e privimit material dhe mundësia për të mbuluar nevojat bazë).

Zërat PMS (pamundësi financiare)	Rreziku për të qenë i varfër			Thellësia e privimit material			Mbulim i nevojave bazë		
	Sig.	Exp (B) (ODD S ratio)	95% C.I. for EXP (B)	Sig.	Exp (B)	95% C.I. for EXP(B)	Sig.	Exp (B) (ODD S ratio)	95% C.I. for EXP (B)
Kanë disa rroba të reja (jo të përdorura).	.000	1.848	(1.808, 1.888)	.000	8.137	(7.923, 8.357)	.000	1.552	(1.505, 1.601)
Kanë dy palë këpucë që u rrinë mirë.	.000	1.729	(1.679, 1.780)	.000	18.153	(17.135, 19.233)	.000	2.430	(2.285, 2.584)
Hanë fruta dhe perime një herë në ditë.	.000	1.375	(1.348, 1.402)	.000	6.234	(6.115, 6.355)	.000	3.209	(3.133, 3.287)
Hanë një vakt me mish, pulë ose peshk një herë në ditë.	.000	1.351	(1.324, 1.377)	.000	7.036	(6.906, 7.168)	.000	2.618	(2.564, 2.673)
Kanë në shtëpi libra të përshtatshëm për moshën e fëmijëve.	.000	2.369	(2.321, 2.417)	.000	5.846	(5.713, 5.982)	.000	1.614	(1.570, 1.660)
Kanë pajisje argëtimi për jashtë shtëpie.	.000	2.248	(2.204, 2.292)	.000	7.717	(7.563, 7.874)	.000	2.002	(1.954, 2.050)
Kanë lojëra për brenda në shtëpi.	.000	2.103	(2.059, 2.149)	.000	9.299	(9.051, 9.554)	.000	1.339	(1.299, 1.381)
Kanë një vend të përshtatshëm për të studiuar ose për të bërë detyrat e shtëpisë.	.000	1.676	(1.640, 1.713)	.000	9.732	(9.501, 9.969)	.000	1.097	(1.068, 1.127)
Marrin pjesë në një veprimtari të rregullt argëtuese.	.000	1.577	(1.545, 1.609)	.000	8.617	(8.455, 8.782)	.000	2.142	(2.098, 2.187)
Kremtime për raste të veçanta.	.000	1.953	(1.913, 1.993)	.000	10.626	(10.369, 10.890)	.000	1.447	(1.407, 1.489)
Ftojnë miq në shtëpi për të luajtur ose për të ngrënë.	.000	2.023	(1.984, 2.063)	.000	6.388	(6.260, 6.519)	.000	2.147	(2.095, 2.201)
Marrin pjesë në udhëtime dhe organizime shkollore.	.000	3.684	(3.599, 3.771)	.000	10.906	(10.668, 11.149)	.000	2.895	(2.821, 2.970)
Shkojnë për pushime nga shtëpia të paktën një javë për çdo vit.	.000	1.793	(1.753, 1.833)	.000	9.692	(9.481, 9.907)	.000	4.108	(4.030, 4.188)
Akses në internet.	.000	2.771	(2.716, 2.827)	.000	3.230	(3.171, 3.290)	.000	2.655	(2.608, 2.703)
Akses në një makinë për përdorim privat.	.000	2.234	(2.188, 2.281)	.000	8.301	(8.136, 8.470)	.000	1.800	(1.767, 1.834)
Zëvendësim i mobiljeve dhe pajisjeve të vjetra.	.000	1.607	(1.572, 1.642)	.000	4.074	(3.990, 4.159)	.000	3.828	(3.760, 3.898)
Shtëpi mjaftueshëm e ngrohtë.	.000	.929	(.911, .947)	.000	5.036	(4.943, 5.131)	.000	3.332	(3.258, 3.409)
Pagesa të prapambetura të kredive ose qirasë, faturave	.000	1.582	(1.551, 1.613)	.000	9.582	(9.375, 9.793)	.000	0.775	(0.756, 0.793)

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

4.3 Testi i besueshmërisë

Testi Alfa e Kronbahut është testi më gjerësisht i përdorur për matjen e besueshmërisë, i cili mat konsistencën e brendshme të një shkalle ose të zërave të testuar. Siç shihet në Tabelën 2, paraqitet një nivel i lartë besueshmërie, me një konsistencë të lartë të brendshme të zërave të testuar, me një rezultat 0.916. Alfa e Kronbahut, përdor konceptin e mungesës së detyruar të zërit, me një prag më të madh se 0.7, që tregon se e kalon këtë test (Guio et al. 2012, 2017).

Në Tabelën 3, kolona që tregon korrelacionin total tregon se sa ndërlidhet çdo zë me zërat e PMS. Kolona që tregon rezultatin e testit Alfa të Kronbahut nëse zëri hiqet, ndihmon për të vendosur nëse do të hiqet çdo zë nga variablat. Rezultati ynë aktual është $\alpha = 0,916$. Nëse një zë hiqet dhe rezultati bie, ne duhet ta mbajmë atë. Mirëpo, nëse ky rezultat rritet pasi është fshirë zëri, ne mund ta heqim atë pasi kjo do ti bënte variabat tanë më të besueshëm.

Tabela 2: Besueshmëria bazuar në testin Alfa të Kronbahut

Statistikat e Besueshmërisë		
Alfa e Kronbahut	Alfa e Kronbahut bazuar në zërat e standardizuar	Numri i zërave
.916	.917	18

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

Tabela 3: Testi Alfa e Kronbahut nëse zëri hiqet

	Mesatarja e shkallës nëse hiqet zëri	Ndryshueshmëria e shkallës nëse hiqet zëri	Zëri i korrektuar-Korrelacioni total	Alfa e Kronbahut nëse hiqet zëri
Kanë një vend të përshtatshëm për të studiuar ose për të bërë detyrat e shtëpisë.	5.9192	24.551	.627	.911
Marrin pjesë në udhëtime dhe organizime shkollore.	5.8061	23.816	.732	.907
Kanë disa rroba të reja (jo të përdorura).	6.0137	25.200	.562	.912
Kanë dy palë këpucë që u rrinë mirë.	6.1237	26.244	.454	.915
Hanë fruta dhe perime një herë në ditë.	5.8698	24.513	.604	.911
Hanë një ushqim me mish, pulë ose peshk një herë në ditë.	5.8039	24.588	.560	.912
Kanë në shtëpi libra të përshtatshëm për moshën e fëmijëve.	5.9463	24.507	.661	.910
Kanë pajisje për të kaluar kohën e lirë për jashtë shtëpie.	5.8840	24.039	.722	.908
Kanë lojëra për brenda në shtëpi.	6.0089	24.866	.645	.910
Marrin pjesë në një veprimtari të rregullta në kohën e lirë.	5.7781	23.865	.712	.908
Kremtime për raste të veçanta.	5.9685	24.583	.666	.910
Ftojnë miq në shtëpi për të luajtur ose për të ngrënë.	5.9209	24.493	.642	.910
Bëjnë pushime larg shtëpisë të paktën për një javë çdo vit.	5.6453	24.038	.668	.909
Akses në internet.	5.6773	24.824	.496	.914
Përdorin makinë private.	5.6677	24.733	.516	.914
Ngrohja e shtëpisë në mënyrë të përshtatshme.	5.8644	25.316	.422	.916
Zëvendësim i mobiljeve dhe pajisjeve të vjetra.	5.5817	24.768	.525	.913
Pagesa të prapambetura.	5.9050	25.450	.410	.916

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

Jemi përpjekur që të fshijmë çdo zë veçmas për të parë nëse rezultati i Alfa të Kronbahut pësonte rritje apo ulje. Nga testi doli se çdo zë paraqet një rënie të vogël të Alfa të Kronbahut. Kështu që u vendos që të mbahen të gjitha variablat (një shembull paraqitet në Tab. 4).

Tabela 4: Testi Alfa e Kronbahut nëse heqim zërin “Marrin pjesë në udhëtime dhe organizime shkollore”

Statistikat e Besueshmërisë për zërin “Marrin pjesë në udhëtime dhe organizime shkollore”		
Alfa e Kronbahut	Alfa e Kronbahut bazuar në zërat e standardizuar	Numri i zërave
0.907	0.909	17


Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

4.4 Testi i aditivitetit

Për testin e Aditivitetit, është përdorur Analiza e Variancës (ANOVA) që synon të paraqesë se fëmijët të cilëve iu mungojnë më shumë zëra jetojnë në familje me të ardhura progresivisht më të ulëta (Guio et al. 2012, 2017).

Grafiku 2, paraqet grafikët e 18 zërave të Privimit Material të testuara për përfshirje në indeksin e privimit material të fëmijëve. Boshti Y paraqet log e të ardhurave të ekuivalentuara të disponueshme të familjeve; pika e anës së majtë në secilin grafik paraqet të ardhurat mesatare të atyre që nuk vuajnë nga privimi dhe pika e anës së djathtë paraqet të ardhurat mesatare të atyre që vuajnë nga privimi. Grafiku 2 paraqet qartë për të 18 zërat se fëmijët që vuajnë nga privimi jetojnë në familje me (mesatarisht) të ardhura familjare shumë më të ulëta.

Grafiku 2: Grafikët e testit ANOVA për zërat e privimit material sipas të ardhurave
Privimet sipas të ardhurave të disponueshme të familjeve



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

Një test i dytë për aditivitetin synon të sigurojë se zërat e privimit material shprehin se familjet me një privim material me 2 pikë (mungesë të 2 zërave) në të vërtetë janë duke vuajtur nga privimi material më shumë sesa familjet me 1 ose 0 pikë (mungesë të 1 zëri ose asnjë mungesë). Kjo është kontrolluar duke përdorur testin ANOVA (ndërveprime të zërave të privimit material të rendit të dytë sipas nivelit të të ardhurave të ekuivalentuara të disponueshme të familjes) (Guio et al. 2012, 2017).


Grafiku 3 paraqet efektet e ndërveprimit të rendit të dytë, që tregohet efekti i ndërveprimit të zërave “veshjeve të reja (jo të përdorura)” dhe “dy palë këpucë të përshtatshme”. Mund të shihen dy vija që tregojnë se:

- Familjet, që nuk kanë privime, vlerësohen të kenë të ardhurat më të larta;
- Familjet, që vuajnë nga dy privime (nuk kanë rroba të reja (jo të përdorura) dhe dy palë këpucë të përshtatshme), vlerësohen të kenë të ardhurat më të ulëta; dhe
- Familjet, që vuajnë nga një privim (ose nuk kanë rroba të reja (jo të përdorura) ose nuk kanë dy palë këpucë që u rrinin mirë), vlerësohen se kanë nivele të mesme të të ardhurave.

Nga ky grafik, arrijmë në përfundimin se zërat PM “rroba të reja (jo të përdorura)” dhe “dy palë këpucë të përshtatshme” ka gjasa që të jenë aditive. Në grafikët e ndërveprimit ku ne shohim dy vija paralele që pjerrësohen nga e majta në të djathtë (siç u pa më lart), tregon se nuk ka probleme aditiviteti. Nëse dy vijat priten ose kryqëzohen, do të thotë se aty mund të ketë probleme aditiviteti (Guio et al. 2012, 2017).


Për ta testuar edhe më tej aditivitetin e zërave të privimit material, u përllogaritën ndërveprimet e dyanshme të log të të ardhurave ekuivalente të disponueshme të familjeve me të gjithë zërat PM që u konsideruan të vlefshëm në testet e mëparshme. Në Grafiku 4, tregohen efektet e ndërveprimit të zërit “disa rroba të reja (jo të përdorura)” me të 17 zërat e tjerë të privimit material. Gjatë testit të aditivitetit, nëse gjenden probleme aditiviteti të ‘një zëri’ me të 17 zërat e tjerë të privimit material për fëmijët, na duhet të vendosim që ta heqim këtë zë nga treguesi përfundimtar i privimit material të fëmijëve. Nëse ka probleme aditiviteti në njërin zë me një numër të vogël të zërave nga 17 zërat e privimit material, atëherë mund ta mbajmë këtë zë në treguesin përfundimtar të privimit material të fëmijëve.

Grafiku 3: Efektet e ndërveprimit për zërat “rroba të reja (jo të përdorura)” dhe “dy palë këpucë të përshtatshme”



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

Grafiku 4: Efektet e ndërveprimit pë zërin “rroba të reja (jo të përdorura)” & të 17 zërat e Privimit Material



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018


Në Grafikon 4, tregohet se zërat ka gjasë që të jenë aditiv për njëri-tjetrin. Vetëm grafiku me kornizë të kuqe, që shpreh efektet e ndërveprimit të zërave “rroba të reja (jo të përdorura)” dhe “Shtëpi e ngrohtë në mënyrë të përshtatshme”, ka probleme aditiviteti. Në aneks gjenden figurat 1 deri 17, ku paraqiten efektet e ndërveprimit të secilit zë me pjesën tjetër të zërave PM. Grafiku i rrethuar me vijë të kuqe paraqet probleme aditiviteti. Prej të gjitha kontrolleve të kryera, arrihet në përfundimin se të gjithë zërat e kanë kaluar testin e aditivitetit dhe do të jenë pjesë e zërave të Privimit Material për përllogaritjen e indeksit.

Të gjithë 18 zërat e privimit material kanë kaluar katër testet e vlerësimit duke siguruar një listë përfundimtare zërash për treguesin e fëmijëve. Me të dhënat e SILC 2018 u krijua treguesi i privimit material në nivel familje për familjet me fëmijë të moshës 0-15 vjeç.

Në grafikun 5, tregohet përqindja e familjeve me fëmijë të moshës nga 0-15 vjeç me mungesë të të paktën 3, 4, 5 zërave nga 18 zërat e Privimit Material. Ky studim shërben për implementimin e indeksit të privimit material të fëmijëve, por ky ushtrim përfaqëson familjet me fëmijë të moshës 0-15 vjeç. Kjo kornizë e punuar me të dhënat e vitit 2018 do të shërbejë për të përllogaritur në të ardhmen e afërt, me të dhënat e SILC 2019, indeksin e privimit të fëmijëve në nivel individual për personat e moshës nën 16 vjeç.

Pasi të identifikohen fëmijët me një, dy, tre ose më shumë privilegje, duhet të vendoset një kufi në rang vendi, përta i përket numrit të privilegjeve që duhet të merren në konsideratë për të quajtur një fëmijë të privuar materialisht për shkak të pamundësisë financiare.

Grafiku 5: Familjet me fëmijë të moshës 0-15 vjeç me mungesë ZËRASH nga 18 zërat e Privimit Material



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës EU-SILC 2018

5. KONKLUZIONET

Dimensione të tjera përveç varfërisë monetare ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve. Disponueshmëria e të dhënave të EU-SILC për treguesit specifik lidhur me fëmijët dhe zërat e privimit material të familjeve ndihmojnë në krijimin e një analize vetëm për privimin material të fëmijëve.

Në rastin e Shqipërisë, ky studim ka përmirësuar kornizën për identifikimin e një sërë zërash optimalë që duhet të përfshihen në treguesin e privimit material të fëmijëve, bazuar në metodën Guio et al. (2012, 2017) dhe përvojën e vendeve evropiane. Në të ardhmen e afërt, kjo kornizë do të ndihmojë në zhvillimin për herë të parë të indeksit të privimit material të fëmijëve dhe do të ndihmojë në monitorimin social në rang vendi.

Si rezultat i kësaj analize, janë përzgjedhur 18 zëra dhe secili prej tyre parashihet të jetë i përshtatshëm, i vlefshëm, i besueshëm dhe aditiv për matjen e privimit material të fëmijëve.


Në rastin e të dhënave të EU-SILC 2018, është kryer një ushtrim në nivel familjesh (familje me fëmijë të moshës 0-15 vjeç) dhe do të shërbejë për zbatimin e Indeksit të Privimit Material të Fëmijëve 2019 në nivel individual për personat nën 16 vjeç.

Kjo analizë është më e përafërt nga ana metodologjike me Indeksin e BE-së për Privimin Material të Fëmijëve, por zërat dhe kufijtë duhet të përzgjidhen me kujdes duke u bazuar në të dhënat e SILC-ut të vendit tonë. Një nga sfidat për vendin është vendosja e kufirit të duhur për privimin e fëmijëve. Ky studim arrin në përfundimin se është shumë me vlerë për Shqipërinë që të hartojë Indeksin e Privimit Material të fëmijëve, por mundësitë që të krahasohet me indeksin e privimit të BE-së, që vendet anëtare e zbatojnë me të dhënat e EU-SILC 2014 janë të pakta.

REFERENCA

1. Anne-Catherine Guio & David Gordon² & Eric Marlier & Hector Najera² & Marco Pomati , (2017), Towards an EU measure of child deprivation.
2. EUROSTAT , (2013). COMMISSION REGULATION (EU) No 112 /2013, Implementing Regulation (EC) No 1177/2003 of the European Parliament and of the Council concerning Community statistics on income and living conditions (EU-SILC) as regards the 2014 list of target secondary variables on material deprivation. fq. 5-7.
3. EUROSTAT, (2008). COUNCIL REGULATION (EC) No 362/2008 , Implementing Regulation (EC) No 1177/2003 of the European Parliament and of the Council concerning Community statistics on income and living conditions (EU-SILC) as regards the (2009) list of target secondary variables on material deprivation. fq 8-10.
4. EUROSTAT (version July 2019), Methodological guidelines and description of EU-SILC target Variables, Doc.065 (2018 operations).
5. Guio, A.-C., Gordon, D., & Marlier, E. (2012). Measuring material deprivation in the EU: Indicators for the whole population and child-specific indicators. Eurostat methodologies and working papers. Luxembourg: Publications Office of the European Union (OPOCE).
6. UNICEF, (2007) , Child poverty in perspective: An overview of child well-being in rich countries, Innocent Report Card Nr. 7 fq.1
7. UNICEF. (2012). Measuring child poverty: New league tables of child poverty in the world's rich countries. Report card Nr. 10
8. Yekaterina Chzhen, Chris de Neubourg, Ilze Plavgo & Marlous de Milliano, (2015). Child Poverty in the European Union: the Multiple Overlapping Deprivation Analysis Approach (EU-MODA)

Aneks: Efektet e ndërveprimit të 18 zërave të Privimit Material



ASPEKTET E CILËSISË SË EDITIMIT DHE IMPUTIMIT PËR ANKETËN E BUXHETIT TË FAMILJES NË SHQIPËRI

Alma Kondi, Instituti i Statistikave
akondi@instat.gov.al

Anisa Omuri, Instituti i Statistikave
aomuri@instat.gov.al

Dan Hedlin, Universiteti i Stokholmit, Suedi
dan.hedlin@stat.su.se

Abstrakt

Projektimi, zhvillimi dhe ekzekutimi i procedurës së editimit dhe imputimit të të dhënave (EI) për Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF) është një procedurë shumë e rëndësishme, qëllimi i së cilës është të garantojë nivelin më të lartë të cilësisë e vlefshmërisë të të dhënave. Kjo nënkupton përcaktimin e të gjitha rregullave përkatëse të editimit që mundësojnë gjetjen e gabimeve në të dhëna dhe imputimin e vlerave të gabuara, të pasakta dhe ato që mungojnë duke u përpjekur të vendosen të dhënat “e sakta” që janë hedhur gabim gjatë procesit të hedhjes së të dhënave. Të gjitha procedurat e projektuara dhe zbatuara për EI përdorin softwaret Concord (modulin SCIA) dhe RIDA për trajtimin e variablave kategorikë dhe variablave numerikë.

Ky artikull përpqet të shpjegojë procedurat e përdorura në Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF) në Shqipëri për editimin dhe imputimin e të dhënave. Do të prodhohet një analizë e hollësishme e rezultateve të procedurës në mënyrë që të vlerësohen efektet e përgjithshme të procedurës së imputimit.

Fjalë kyçe:

Editimi, Imputimi, Donatorët, SCIA, RIDA, ABF në Shqipëri

1. HYRJE

Çdo anketë (Cens ose anketë me kampion) është subjekt i gabimeve që nuk vijnë nga kampionimi sepse ato janë të pranishme në çdo hap të një ankete statistikore. Në këtë artikull ne përqendrohemi në dy lloje gabimesh që nuk vijnë nga kampionimi të cilat ndikojnë në rezultatet e anketës:

- Të dhëna të gabuara
- Të dhëna që mungojnë në zëra të veçantë, domethënë kur njësia ekonomike familjare është përgjigjur, por mungojnë vlerat e disa zërave të veçantë.

Imputimi është procesi i zëvendësimit të një vlere të gabuar ose plotësimit të një vlere që mungon me një vlerë më të përshtatshme. Të dhëna që mungojnë në zëra të veçanta (nivel variabli) zakonisht trajtohen me imputim ndërsa të dhënat që mungojnë në njësi (nivel rekordi), domethënë kur nuk ka të dhëna nga një njësi e kampionit (njësi ekonomike familjare), përdoret përgjithësimi për të vlerësuar indikatorët.

Metoda e përdorur për analizën e të dhënave është OLS (Metoda e katrorëve më të vegjël). Si një analizë parashikuese duke plotësuar disa kushte në lidhje me linearitetin e të dhënave, zgjedhjen në mënyrë rastësore të vrojtimit, mungesës së heteroskedasticitetit etj. Ky regresion është përdorur për të shpjeguar marrëdhënien midis një variabli të varur të vazhdueshëm dhe dy ose më shumë variabla të pavarur. Për të vlerësuar modelin e produktivitetit të punës është përdorur një zgjedhje ndërsektoriale e ndërmarrjeve, ku përfshihen të dhëna nga ndërmarrje të ndryshme që zhvillojnë aktivitet ekonomik në ekonominë shqiptare. Modeli vijon si më poshtë:

(1) Produktiviteti i punës = f (Prodhim, paga, intensiteti i kapitalit, karakteristikat e ndërmarrjeve, treguesit TIK)

Ku: produktiviteti i punës është matur si vlerë e produktivitetit vjetor për çdo njësi pune në nivel ndërmarrje. Variablat kyç, përcaktues të produktivitetit të punës janë pagat dhe intensiteti i kapitalit, i shprehur si kapital për punonjës. Treguesit mbi karakteristikat e ndërmarrjeve përfshijnë: madhësinë, moshën dhe aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve. Treguesit TIK përfshijnë: prezencën e një faqe web-i dhe përdorimin e pajisjeve portative për aksesin e email-eve dhe dokumentet e punës.

Në vijim, duke përdorur si model analize dhe vlerësimi modelin e aplikuar nga Heshmati (2016) në lidhje me produktivitetin e punës në Kenia për industrinë prodhuese dhe shërbimet do të jepet përshtatja e analizës dhe vlerësimit për rastin e Shqipërisë.

3.2 Baza e të dhënave dhe natyra e tyre

Të dhënat e përdorura në këtë studim janë bazuar në dy burime të dhënash të cilat janë të disponueshme nga Instituti i Statistikave. Këto statistika janë prodhuar duke përdorur të dhëna nga: Vrojtimi mbi Statistikat Strukturore (ASN) dhe Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje.

Qëllimi kryesor i Statistikave Strukturore të ndërmarrjeve është të tregojë strukturën e sektorëve të biznesit në lidhje me të dhënat ekonomike. Të dhënat përshkruajnë strukturën ekonomiko-financiare të ndërmarrjeve në nivel vendi, sipas degëve të ekonomisë dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

Statistikat Strukturore të ndërmarrjeve (ASN)¹ bazohen në një vrojtimit me zgjedhje dhe mbulojnë të gjitha ndërmarrjet që prodhojnë të mira dhe shërbime për treg të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2)² dhe kanë aktivitet kryesor nga (B) në (S) duke përjashtuar S94 të kësaj nomenklature. Statistikat Strukturore të ndërmarrjeve përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri në të gjitha format ligjore. Popullsia përbëhet nga të gjitha ndërmarrjet që sipas Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve ishin aktive në Dhjetor të vitit referues dhe kanë aktivitetin e tyre ekonomik në një nga aktivitetet e mbuluara nga ASN. Statistikat Strukturore të ndërmarrjeve matin rezultatet e ndërmarrjeve, investimeve, punësimit dhe koston e punës sipas degëve dhe madhësisë së ndërmarrjeve. Kampioni i vrojtimit të ASN përfshin afërsisht 15,600 ndërmarrje. Klasifikimi i variablit “madhësia e ndërmarrjeve” bëhet në grupet e mëposhtme të punësimit:

- Ndërmarrjet me 1 të punësuar
- Ndërmarrjet me 2-4 të punësuar
- Ndërmarrjet me 5-9 të punësuar
- Ndërmarrjet me 10-19 të punësuar
- Ndërmarrjet me 20-49 të punësuar
- Ndërmarrjet me 50-79 të punësuar
- Ndërmarrjet me 80-249 të punësuar
- Ndërmarrjet me 250 ose më shumë të punësuar

¹<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/metadata-strukturore/regjister/?regId=19&varId=69>

²<http://www.instat.gov.al/media/1838/nve.pdf>

Të gjitha ndërmarrjet me 10 ose më shumë të punësuar janë përfshirë në këtë vërtetim. Metoda e përdorur është metoda Stratified Systematic Random Sampling (SSRS). Stratifikimi bazohet në kombinimin e grup aktivitetit ekonomik me madhësinë e ndërmarrjes. Klasifikimi i ndërmarrjeve është kryer sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev.2, ndërsa klasifikimi i madhësisë së klasave të ndërmarrjeve realizohet nga numri i punonjësve, i matur si ekuivalent me kohë të plotë.

Vërtetimi mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit nga ndërmarrjet siguron tregues për përdorimin e TIK nga ndërmarrjet ekonomike (TIK-ENT)³. Vërtetimi i TIK-ENT është një vërtetim me zgjedhje që përfshin të gjitha ndërmarrjet aktive që kryejnë veprimtari nga C në N duke përfshirë S 95.1 të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2). Njësitë e vërtetuara janë ndërmarrje me 10 ose më shumë të punësuar që kanë qenë aktive sipas Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve. Vërtetimi i TIK-ENT përfshin një kampion prej afro 1.500 ndërmarrjeve nga të gjitha format ligjore.

Të dhënat e përdorura në punim janë siguruar nga lidhja e të dhënave individuale nga vërtetimi i ASN dhe TIK në ndërmarrje. Lidhja e të dhënave nga këto dy vërtetime është realizuar për vitin referencë 2017. Vërtetimi i TIK ka filluar të kryhet prej vitit 2015, ndaj dhe lidhja e serive kohore me të dhënat e vërtetimit të ASN është e kufizuar.

Variablat e analizuar nga vërtetimi i ASN janë: aktiviteti ekonomik (sipas kodit dyshifror të NVE Rev.2), numri i punonjësve, pagat, intensiteti i kapitalit dhe madhësia e ndërmarrjeve, duke iu referuar numrit të punonjësve dhe mosha e ndërmarrjeve. Variablat e analizuar nga vërtetimi i TIK-ENT janë treguesit lidhur me përdorimin e kompjuterit, internetit, prezencës së faqes së web-it, punonjësit që merren me TIK, përdorimi i pajisjeve portative për të aksesuar email-in dhe hapësira e punës, përdorimi i paketës ERP (paketa për planifikimin e burimeve sipërmarrëse), përdorimi i paketës CRM për marketing dhe përdorimi i informacionit elektronik për zinxhirët e furnizimit.

Të dhënat e përdorura në këtë punim janë marrë nga vërtetimet e kryera nga Instituti i Statistikave bazuar në metodologjinë e Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian, Eurostat. Këto të dhëna janë marrë nga lidhja e të dhënave mikro nga dy vërtetimet, ASN dhe TIK në ndërmarrje ku konsistojnë 1,046 ndërmarrje të vërtetuara dhe përgjigjura në ekonominë vendase për vitin 2017. Pra, kemi të bëjmë me një analizë faktorësh në të dhëna në nivel ndër sektorial.

Variabli i varur është produktiviteti i punës i përcaktuar si vlera gjithsej e prodhimit të realizuar për vitin për

prodhuesit e të mallrave dhe shërbimeve (IZA,2016). Intensiteti i kapitalit është matur si vlera gjithsej e investimeve për vitin referues në makineri, automjete, pajisje dhe investimi vjetor në tokë, ndërtesë dhe strukturat e punës, i cili pritet të ketë një efekt pozitiv në produktivitetin e punës.

Variabli pagë përcakton pagën mesatare për punonjës dhe është marrë si raport i pagave gjithsej ndaj numrit gjithsej mesatar vjetor të punonjësve. Ky variabël përfshin pagat, rrogat dhe përfitimet e tjera, duke përfshirë ushqimin, transportin dhe sigurimin shoqëror.

Variabli i karakteristikave të ndërmarrjes i referohet moshës, madhësisë dhe aktivitetit ekonomik.

Mosha e ndërmarrjes është matur si numri i viteve të operuara në treg. Madhësia e ndërmarrjes është klasifikuar në bazë të numrit të punonjësve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Janë përdorur tre grupe punësimi: 10-49, 50-249 dhe 250+. Bazuar në aktivitetin ekonomik, ndërmarrjet janë klasifikuar në dy grupe kryesore: prodhues të të mirave dhe prodhues të shërbimeve.

Në kategorinë e treguesve të TIK, përdorimi i faqes së web-it përfshin rastet kur një ndërmarrje ka një faqe të saj web-it dhe e përdor për të komunikuar me klientët dhe furnitorët (p.sh të publikojë katalogë produktesh ose çmimesh, etj.) dhe përdorimi i pajisjeve portative për të aksesuar email-et dhe hapësirat ku janë vendosur materialet e punës (ndërmarrjet mund të hapin nga jashtë vendit të punës email-et, dokumentat, etj.).

Produktiviteti i punës, intensiteti i kapitalit dhe variabli i pagës paraqiten në formën logaritmike.

Transformimi i variablave në formë logaritmike për ti paraqitur në një model regresioni është një mënyrë e zakonshme për të trajtuar rastet kur ekziston një marrëdhënie jo-lineare midis variablave të pavarur dhe atyre të varur. Transformimet logaritmike janë gjithashtu një mjet i përshtatshëm për të transformuar një variabël shumë të anuar në një variabël që është afërsisht normale. Koeficientët reflektojnë ndryshimin në përqindje në produktivitetin e punës kur rritet me një përqind intensiteti i kapitalit dhe variablat e pagës. Variablat e TIK janë variabla binar që marrin vlerën 1 kur ka prezencë të treguesve të faqes së web-it dhe përdorimit të pajisjeve të lëvizshme për treguesin tjetër, ndërsa në të kundërt marrin vlerën 2.

³ <http://www.instat.gov.al/al/temat/shkenc%C3%AB-teknologji-dhe-inovacion/informacioni-dhe-teknologji%C3%AB-e-komunikimit/>

3.3 Specifikimi i modelit dhe vlerësimi

Statistikat përmbledhëse në lidhje me variablat e faktorëve të prodhimit, produkteve të prodhuara, puna, karakteristikat e ndërmarrjeve dhe treguesit TIK të përdorur në studim janë paraqitur në Tabelën 1. Duke u nisur nga heterogjeniteti i kampionit të marrë në shqyrtim dhe ndryshimet midis ndërmarrjeve sipas variablave të marrë në shqyrtim, vlera e koeficientit të variacionit (CV) paraqitet e lartë për shkak të devijimit standard të paraqitur për disa nga variablat të tillë si: prodhimi, pagat, intensiteti i kapitalit, numri i të punësuarve, intensiteti i kapitalit/numri i të punësuarve, prodhimi/numri i të punësuarve dhe përdorimi i pajisjeve portative. Këto vlera shpjegohen me faktin se në kampionin e analizuar përfshihen ndërmarrje të madhësive të ndryshme dhe si pasojë shuma e devijimit standard në raport me mesataren e kampionit në treguesit e mësipërm, është më e lartë se 1. Ndryshe paraqiten treguesit mbi pagat/numri i të punësuarve, mosha e ndërmarrjes, aktiviteti ekonomik, madhësia e ndërmarrjes, prania e faqes së web-it dhe përdorimi i pajisjeve portative.

Pavarësisht heterogjenitetit të kampionit të marrë në shqyrtim, këto tregues paraqesin një $CV < 1$ për shkak se disa nga variablat e analizuar paraqiten si variabla binar. Si pasojë, devijimi standard nuk paraqitet i lartë, veçanërisht për variablat e anketës së TIK në ndërmarrje.

Për të kontrolluar kolinearitetin midis variablave shpjegues, koeficientët e korrelacionit midis të gjithë variablave janë paraqitur në Tabelën 2. Produktiviteti i punës paraqitet i lidhur pozitivisht me variablin e pagave të punonjësve, por jo me kapitalin. Asnjë nga kombinimet nuk ka korrelacion më të lartë se 0.50. Kjo do të thotë që midis të dhënave nuk rezulton multikolinearitet. Variablat e moshës së ndërmarrjes, madhësisë dhe aktivitetit ekonomik nuk tregojnë asnjë lidhje me produktivitetin e punës.

Tabela 1: Statistika Përshkruese

Statistika Përshkruese						
	N	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Dev. Standard	CV=Dev.sta/Mes.
Prodhimi (mijë lekë)	1046	-	54,647,430	478,779	2,072,468	4.33
Pagat (mijë lekë)	1046	800	4,217,728	71,835	203,851	2.84
Intensiteti i kapitalit (mijë lekë)	1046	-	8,489,540	55,444	332,951	6.01
Numri i të punësuarve	1046	11	6,488	132	285	2.16
Intensiteti i kap(mijë lekë)/Nr i të punësuarve	1046	-	36,391	465	1,892	4.07
Prodhimi (mijë lekë)/ Nr i të punësuarve	1046	-	532,981	4,098	17,291	4.22
Paga(mijë lekë)/Nr i të punësuarve	1046	21	8,039	499	463	0.93
Mosha e ndërmarrjes	1046	1	27	13	7	0.52
Aktiviteti ekonomik	1046	1	2	2	1	0.33
Madhësia e ndërmarrjes	1046	1	3	2	1	0.37
Prania e faqes së web-it	1030	-	1	1	0	0.65
Përdorimi i pajisjeve portative	1046	-	1	0	0	1.50
N të vlefshme	1030					

Burimi: Anketa Strukturore pranë ndërmarrjeve, Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, Llogaritje të autorëve, 2019

Tabela 2: Korrelacioni midis variablave të vlerësuar

		LN Paga/ Nr punonjës	LN intensitet et kapitali/ Nr punonjës	Mosha e ndërm.	Aktiviteti ekono.	Madhësia e ndërm.	Prezenca e web	Përdor Pajisje portative
LN Produkt/ Nr punonjës LN Paga/ Nr punonjës	N	1041	776	1041	1041	1041	1025	1041
	Korrelacioni Pearson	1	.189**	-.006	.264**	.091**	.260**	.253**
	Sig. (2-tailed)		.000	.852	.000	.003	.000	.000
LN Paga/ Nr punonjës LN intensitet kapital/ Nr punonjës	N	1046	778	1046	1046	1046	1030	1046
	Korrelacioni Pearson	.189**	1	.135**	.030	-.049	.180**	.131**
	Sig. (2-tailed)	.000		.000	.398	.175	.000	.000
LN intensitet kapital/ Nr punonjës Mosha e ndërmarrjes	N	778	778	778	778	778	767	778
	Korrelacioni Pearson	-.006	.135**	1	-.187**	.119**	.059	.040
	Sig. (2-tailed)	.852	.000		.000	.000	.060	.201
Mosha e ndërmarrjes Aktiviteti ekonomik	N	1046	778	1046	1046	1046	1030	1046
	Korrelacioni Pearson	.264**	.030	-.187**	1	-.127**	.201**	.116**
	Sig. (2-tailed)	.000	.398	.000		.000	.000	.000
Aktiviteti ekonomik Madhësia e ndërmarrjes	N	1046	778	1046	1046	1046	1030	1046
	Korrelacioni Pearson	.091**	-.049	.119**	-.127**	1	.269**	.169**
	Sig. (2-tailed)	.003	.175	.000	.000		.000	.000
Madhësia e ndërmarrjes Prezenca e faqes web	N	1046	778	1046	1046	1046	1030	1046
	Korrelacioni Pearson	.260**	.180**	.059	.201**	.269**	1	.261**
	Sig. (2-tailed)	.000	.000	.060	.000	.000		.000
Prezenca e faqes web Përdorimi i pajisjeve portative	N	1030	767	1030	1030	1030	1030	1030
	Korrelacioni Pearson	.253**	.131**	.040	.116**	.169**	.261**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	.000	.201	.000	.000	.000	
Përdorimi i pajisjeve portative **. Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin e rëndësishëm 0.01 (2- anshëm).	N	1046	778	1046	1046	1046	1030	1046

Burimi: Anketa Strukturore pranë ndërmarrjeve, Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, Llogaritje të autorëve, 2019

Modeli në ekuacion u vlerësua me Metodën e katrorëve më të vegjël (OLS)⁴. Këto modele ndryshojnë nga modeli bazë i përgjithësuar nga vektorët e ndërmarrjeve, punës dhe variablat e karakteristikave të ndërmarrjeve. Këto modele u përdorën për të studiuar ndikimet e kategorive të ndryshme të faktorëve në produktivitetin e punës të prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve në vend në nivel ndërmarrje. Fillimisht, janë analizuar rezultatet e vlerësimit për modelin bazë nga ku rezultoi se produktiviteti i punës ndikohej vetëm nga variablat kryesor, intensiteti i kapitalit dhe pagat. Më tej, në modelin e dytë janë shtuar variablat e karakteristikave të ndërmarrjeve. Ky model u plotësua duke shtuar edhe variablat e kategorisë TIK. Modeli i tretë përfshin shtatë tregues TIK, nga ku vetëm dy variabla rezultuan të jenë të

rëndësishëm dhe të kenë ndikim në produktivitetin e punës. Modeli i tretë është zgjedhur si më i mirë dhe i specifikuar, ku të gjithë variablat janë të rëndësishëm statistikisht dhe të arsyeshëm në shpjegimin e variacionit në produktivitetin e punës për prodhuesit e të mirave dhe shërbimeve në vend. Modeli i parë rezultoi modeli më i kufizuar dhe Modeli i katërt, modeli i specifikuar si më i përgjithshëm. Modelet janë të mbivendosura ndaj dhe lejojnë testimin për zgjedhjen e specifikimeve të duhura të modelit. Rezultatet e testit tregojnë se modeli i katërt u konsiderua si modeli me formën funksionale më të specifikuar i cili shërbeu edhe si bazë për analizën. Performancat e secilit model u matën nëpërmjet koeficientit të përcaktueshmërisë, R² i rregulluar, në shpjegimin e variacionit në produktivitetin e punës të paraqitur në Tabelën 3. Në shtojcën e punimit, mund të gjenden të gjitha statistikat e katër modeleve të analizuar.

⁴ Katër modele regresioni janë ndërtuar dhe vlerësuar duke përdorur paketën statistikore SPSS.

Tabela 3: Vlerësimet e parametrave nëpërmjet Metodës së katrorëve më të vegjël në produktivitetin e punës, N=1046

Variablat	Model 1		Model 2		Model 3		Model 4	
	Koeficient	Gabimet Standarde Robuste	Koeficient	Gabimet Standarde Robuste	Koeficient	Gabimet Standarde Robuste	Koeficient	Gabimet Standarde Robuste
Konstante	2.102	.371	2.103	.362	2.663	.396	2.618	.372
LNPaga/ Nr punonjësish	.792	.062	.952	.062	.868	.066	.878	.063
LNIntenskapital/ Nr punonjësish	.177	.016	.162	.015	.145	.016	.146	.015
Mosha e ndërmarrjes			.016	.005	.014	.005	.014	.005
Aktiviteti ekonomik			-.433	.065	-.518	.069	-.512	.066
Madhësia e ndërmarrjes			-.269	.048	-.358	.052	-.355	.050
Prezenca e faqes Web					.333	.077	.333	.075
Të punësuar me njohuri TIK					.019	.076		
Përdorimi i pajisjeve portabël					.193	.071	.201	.069
Përdorimi i paketës ERP					.102	.065		
Paketa CRM marketing					-.034	.087		
Përdorimi i informacionit elektronik për zinxhirët e furnitorëve					-.056	.104		
R ²	0.312		0.380		0.408		0.406	

Burimi: Anketa Strukturore pranë ndërmarrjeve, Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, Llogaritje të autorëve, 2019

Duke pasur parasysh kampionin heterogjen, si dhe faktin që të dhënat e analizuar i referohen vetëm një viti, R² rezulton relativisht i lartë, në intervalin 0.312 dhe 0.408. Ndërmarrjet me 1-9 të punësuar që janë të përfshirë në vërtetimin e ASN numërojnë afërsisht 94% të prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve në ekonominë shqiptare, por ky grup i ndërmarrjeve nuk është i përfshirë në vërtetimin e TIK në ndërmarrje si rezultat i metodologjisë së ndjekur për këtë vërtetim. Në tabelën 4 është paraqitur modeli 4 si modeli i pranuar për analiza të mëtejshme.

Për këtë model janë testuar dhe plotësuar kushtet kryesore bazuar te Wooldridge (2012) në lidhje me linearitetin e variablit zgjedhje rastësore e kampionit të përfshirë, pritja matematikore e gabimit standard ndaj variablave të pavarur është 0. Gjithashtu, është kryer testi për praninë e heteroskedasticitetit dhe rezultoi që Signifikanca=0.08>0.05. Në nivelin 5% të besueshmërisë, ky model nuk ka prani të heteroskedasticitetit, pra hipoteza 0 nuk rrëzohet dhe gabimi standard në vlera të ndryshme të variablave të pavarur ka një variancë konstante.

Tabela 4: Statistikat përmbledhëse të regresionit të analizuar

Koeficientët ^a					
Modeli	Koeficientët e Pastandartizuar		Koeficientët e Standartizuar	t	Sig.
	B	Gabimi Standart	Beta		
(Konstante)	2.618	.372		7.044	.000
LN Paga/Nr punonjësish	.878	.063	.427	13.836	.000
LN Intensitet Kapital/Nr punonjësish	.146	.015	.278	9.454	.000
Mosha e ndërmarrjeve	.014	.005	.090	3.085	.002
Aktiviteti ekonomik	-.512	.066	-.237	-7.728	.000
Madhësia e ndërmarrjes	-.355	.050	-.214	-7.139	.000
Prezenca e faqes Web	.333	.075	.139	4.426	.000
Përdorimi i pajisjeve portative	.201	.069	.087	2.925	.004

a. Variabli i Varur: LN Produktiviteti/Nr punonjësish
 Burimi: Anketa Strukturore pranë ndërmarrjeve, Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, Llogaritje të autorëve, 2019

Variablat e produktivitetit të punës, intensitetit të kapitalit dhe paga ushndërrojnë në formën logaritmike. Koeficientët janë paraqitur në formën e elasticitetit konstant, duke e lehtësuar interpretimin e drejtpërdrejtë. Ato pasqyrojnë ndryshimin në përqindje në produktivitetin e punës në përgjigje të ndryshimeve në përqindje në intensitetin e faktorëve të kapitalit dhe pagave. Në të gjitha modelet, elasticiteti i pagës është pozitiv (në intervalin 0.062 dhe 0.88) dhe statistikisht i rëndësishëm me një interval besimi rreth 99%. Në përputhje me teorinë dhe pritjet tona, një nivel më i lartë i pagave rrit produktivitetin e punës. Pagat kanë efektin më të fortë në nivelin e produktivitetit të punës. Siç pritej, paga dhe intensiteti i kapitalit janë përcaktuesit kryesorë të produktivitetit të punës të ndërmarrjeve vendase. Në modelin e thjeshtë, efektet e intensitetit të kapitalit (0.177) në produktivitetin e punës ishin më të dobëta se ato të pagave (0.792). Variabli “Aktivitet ekonomik” paraqitet si një variabël binar ku nëse është industri prodhimi, merr vlerën 1 dhe nëse është industri shërbimi, merr vlerën 0. Nga rezultati i regresionit, rezulton se aktiviteti ekonomik ka 51,2 % produktivitet/numër punonjësish, më të ulët se aktiviteti i shërbimit. Në lidhje me treguesin “Madhësia e ndërmarrjes”, paraqiten grupet e ndërmarrjeve sipas numrit të punonjësve ku me 1 shënohen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 249 punonjës dhe me 0 nëse është ndërmarrje e madhe me mbi 249 punonjës. Nga regresioni rezulton se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme rezultojnë me 35,5% më pak produktivitet/numër punonjësish sesa ndërmarrjet e mëdha. Në modelin e dytë u shtuan karakteristikat e ndërmarrjes si mosha, madhësia e ndërmarrjes dhe aktiviteti ekonomik. Koeficienti i moshës së ndërmarrjes është statistikisht i rëndësishëm dhe pozitiv që sugjeron një lidhje pozitive midis produktivitetit të punës dhe moshës së një firme në treg. Kjo tregon se faktori punë ishte më produktiv në

ndërmarrjet që kanë një moshë më të vjetër në treg sesa në ndërmarrjet më të reja në treg, gjë e cila mund të shpjegohet edhe nga përvoja e biznesit me kalimin e viteve në treg. Treguesit e kategorisë TIK, të përfshira në modelin e përzgjedhur, rezultuan statistikisht të rëndësishëm dhe kanë shenjat e pritura; kanë ndikim pozitiv në produktivitetin e punës të një ndërmarrje.

4. KONKLuzionet

Produktiviteti i punës reflektohet në aftësinë e një ndërmarrje për të gjeneruar prodhim apo vlera të larta të prodhimit. Ekonomia shqiptare është një ekonomi e vogël dhe ndërmarrjet e konsiderojnë të rëndësishme investimin në TIK, të cilat ndikojnë në rritjen e produktivitetit të punës. Ka implikime të forta se rritja e produktivitetit çon në rritjen e jetëgjatësisë së bizneseve në treg.

Ky punim analizon produktivitetin e punës dhe përcaktuesit e tij në ndërmarrjet që prodhojnë të mira dhe shërbime në Shqipëri. Studimi ofron një vlerësim të ri bazuar në të dhëna të reja të produktivitetit të punës në ekonominë shqiptare. Të dhënat e analizuar janë marrë nga dy vrojtimitet e kryera nga Instituti i Statistikave për vitin 2017. U vu re se intensiteti i kapitalit dhe pagat ndikojnë dukshëm në produktivitetin e ndërmarrjes. Produktiviteti i punës reflekton aftësinë e ndërmarrjes për të gjeneruar prodhim më të lartë ose një raport më të lartë të prodhimit për të punësuar.

Për të kuptuar më mirë përcaktuesit që ndikojnë në produktivitetin e punës, u studiua edhe besimi i bizneseve në përdorimin e teknologjive të tilla si: përdorimi i pajisjeve të lëvizshme për të aksesuar postën elektronike, dokumentat e punës dhe përdorimin e faqeve të internetit për komunikim.

Rezultatet e marra janë në përputhje me rezultatet e studimeve të tjera të kryera mbi produktivitetin e punës. Të dhënat janë analizuar në nivel ndërmarrje, gjë e cila ndihmon për të kuptuar më mirë kushtet e prodhimit dhe mjedisit të tregut të ndërmarrjeve individuale.

Sigurisht është pozitiv fakti që kampioni i përzgjedhur mbulon si prodhuesit e të mirave ashtu dhe prodhuesit e shërbimeve. Nga rezultatet e studimit, vihet re se intensiteti i kapitalit dhe pagat ndikojnë ndjeshëm dhe pozitivisht në produktivitetin e punës. Pagat kanë efektin më të madh në nivelin e produktivitetit të punës. Siç pritej, paga dhe intensiteti i kapitalit ishin përcaktuesit kryesorë të produktivitetit të punës të ndërmarrjeve shqiptare. Sa i përket karakteristikave të ndërmarrjeve, si moshë, madhësia dhe veprimtaria ekonomike, vihet re një marrëdhënie pozitive midis produktivitetit të punës dhe moshës në treg të ndërmarrjeve. Mbështetja në teknologji të tilla si, posta elektronike dhe faqet e internetit për qëllime të komunikimit kanë ndikim të rëndësishëm pozitiv në produktivitetin e punës.

Ky studim ka disa kufizime, kryesisht për shkak të natyrës së të dhënave të përdorura. Janë marrë në konsideratë të dhënat e një viti nga dy vrojtimet e kryera nga Instituti i Statistikave si dhe janë analizuar vetëm të dhënat të cilat mund të lidheshin nga dy vrojtimet; ndërmarrjet me 1-9 të punësuar që mbulojnë 94% të prodhuesve të përgjithshëm të të mirave dhe shërbimeve në ekonominë shqiptare nuk janë analizuar. Ky grup ndërmarrjesh nuk është analizuar pasi nuk përfshihet në metodologjinë dhe vrojtimin e TIK në ndërmarrje.

Kufizim tjetër i këtij punimi është mungesa e analizimit të ndërmarrjeve të cilat kanë aktivitet në bujqësi, aktivitetet financiare, aktivitetet e administrimit publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm dhe arsimit dhe shëndetësia nga ndërmarrjet shtetërore. Ky punim mori në studim vetëm prodhuesit e të mirave dhe shërbimeve, dhe nuk analizoi ndikimin e ndërmarrjeve në secilin sektor apo degë të ekonomisë. Megjithatë kufizimet e të dhënave, punimi jep një kontribut të rëndësishëm në ilustrimin e ndikimit që ka rritja e investimeve në teknologji në rritjen e produktivitetit të bizneseve.

REFERENCA

1. Audretsch, D. B. & Welfens, P. J. (2002). The New Economy and Economic Growth in Europe and the US. New York: Springer. <http://dx.doi.org/10.1007/978-3-540-24826-2>.
2. Authority of Electronic and Postal Communications, 2017, National Information and Communication Technologies Strategy, Republic of Albania.
3. Bagley, S. (2010). "How to Calculate productivity of Labour".
4. Brynjolfsson, E. (1993). The Productivity Paradox of Information Technology. Communications of the ACM. <http://dx.doi.org/10.1145/163298.163309>.
5. Brynjolfsson, E. (1994). The Three Faces of IT Value: Theory and Evidence. Proceedings of the International Conference on Information System, Vancouver: British Colombia
6. Brynjolfsson, E. & Hitt, L. (1995). Information Technology as a Factor of Production: the Role of Differences Among Firms. Economics of Innovation and New Technology, 3, 183–199. <http://dx.doi.org/10.1080/10438599500000002>.
7. Brynjolfsson, E. & Hitt, L. (1998). Beyond the productivity paradox. Communications of the ACM, 41(8), 49–55. <http://dx.doi.org/10.1145/280324.280332>
8. Colecchia, A. & Schyler, P. (2001). The Impact of Information Communications Technology on Output Growth. STI Working Paper, 7, OECD.
9. Davidavičienė, V. (2008). Change management decisions into information age. Journal of Business Economics and Management, 9(4), 299–307, <http://dx.doi.org/10.3846/1611-1699.2008.9.299-307>.
10. Dedrick et al., (2003), "The Impacts of Information Technology on Total Factor Productivity: A Look at Externalities and Innovations", AZ 85287-4606, USA.
11. Frankel, M. & Kendric, W. J. (2008). Labour Productivity. Article from Britannica Concise Encyclopaedia. Available from internet:
12. <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/478036/productivity>.
13. Gilchrist, Simon & Gurbaxani, Vijay & Town, Robert. (2001). Productivity and the PC Revolution.
14. Gomez, S., Musso, A., Stocker, M. & Turunen, J. (2006). Labour Productivity Developments in the Euro Area. ECB Oc casional Paper Series, No. 53. Available from internet: <http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpops/ecbocp53.pdf>.
15. Heshmati, Almas; Rashidghalam, Masoomah, 2016, "Labour Productivity in Kenyan Manufacturing and Service In dustries", IZA DP No. 9923.
16. Jorgenson, D.W. (2001). Information Technology and the U. S. Economy. American Economic Review, 91(1), 1–32. <http://dx.doi.org/10.1257/aer.91.1.1>.
17. Katz, R.L. (2009). The Economic and Social Impact of Telecommunications Output. Intereconomics, 41–48, <http://dx.doi.org/10.1007/s10272-009-0276-0>.
18. Krugman, P. (1992). Second Thoughts on EMU. Japan and the World Economy, 4(3), 187–200, [http://dx.doi.org/10.1016/0922-1425\(92\)90007-D](http://dx.doi.org/10.1016/0922-1425(92)90007-D)
19. Levine, R. (1997), "Financial development and economic growth: views and agenda", Journal of Economic Literature, Vol. 35 No. 2, pp. 688-726.

20. Oliner, S. D. & Sichel, D. E. (2000). The resurgence of growth in the late 1990s: Is information technology the story? *Journal Economic Perspective*. 14(4), 3–22,
21. <http://dx.doi.org/10.1257/jep.14.4.3>.
22. Quah, D. (2002). Technology dissemination and economic growth: some lessons for the New Economy. In: ChongEn, Bai; Chi-Wa, Yuen (ed.). *Technology and the New Economy*: 95-156, chapter 3. Cambridge: MIT Press.
23. Rangriz, V. & Raja, B. (2011). Productivity & information and communication technology (ICT) – The explanations behind the paradox of ICT. *Asian Journal of Development Matters*, 5(3), 183–198.
24. Van Ark, B. & Monnikhof, E.J. (2000). Productivity and unit labor cost comparisons. Employment paper 2000/5. Geneva: ILO.
25. Wooldridge, J. M. (2009). “Introductory Econometrics: A modern approach”, Editon no.5, International student edition., [Mason (OH)]: South-Western, Cengage Learning.
26. Zhen-Wei Qiang, Ch., Pitt, A. & Ayers, S. (2003), “Contribution of Information and Communication Technologies to Growth” World Bank Working Paper No. 24. <http://dx.doi.org/10.1596/0-8213-5722-0>.

Anekset

Modeli 1

Variables Entered/Removed ^a						
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method			
1	LNIntenskapital/Nr punonjësish Mosha e ndërm./Nr punonjësish ^b		Enter			
a. Dependent Variable: LNProdhimi/ Nr punonjësish						
b. All requested variables entered.						
Model Summary						
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate		
1	.559 ^a	.312	.310	.88929		
a. Predictors: (Constant), LNIntenskapital/Nr punonjësish, Mosha e ndërm./Nr punonjësish						
ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	277.197	2	138.598	175.257	.000 ^b
	Residual	611.311	773	.791		
	Total	888.507	775			
a. Dependent Variable: LNProdhimi/Nr punonjësish						
b. Predictors: (Constant), LNIntenskapital/Nr punonjësish, Mosha e ndërm./Nr punonjësish						
Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	2.102	.371		5.670	.000
	Mosha e ndërm./Nr punonjësish	.792	.062	.386	12.695	.000
	LNIntenskapital/Nr punonjësish	.177	.016	.337	11.086	.000
a. Dependent Variable: LNProdhimi/Nr punonjësish						

Anekset

Modeli 2

Variables Entered/Removed ^a			
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Madhësia e ndërmarrjes, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Aktiviteti Ekonomik, Mosha e ndërmarrjes, LNPaga/Nr punonjësish b	.	Enter
a. Dependent Variable: LNProdhimi/Nr punonjësish			
b. All requested variables entered.			

Model Summary				
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.616 ^a	.380	.375	.84616
a. Predictors: (Constant), GroupSME, LNIntenskapital/Nr punonjësish,, Aktiviteti Ekonomik, Mosha e ndërmarrjes, LNPaga/ Nr punonjësish				

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	337.193	5	67.439	94.189	.000 ^b
	Residual	551.314	770	.716		
	Total	888.507	775			
a. Dependent Variable: LNProdhimi/Nr punonjësish						
b. Predictors: (Constant), madhësia e ndërmarrjes, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Mosha e ndërmarrjes, LNPaga/ Nr punonjësish, Aktiviteti ekonomik						

Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
	(Constant)	2.103	.362		5.814	.000
	LNPaga/Nr punonjësish	.952	.062	.464	15.257	.000
	LNIntenskapital/Nr punonjësish	.162	.015	.307	10.463	.000
	Mosha e ndërmarrjes	.016	.005	.102	3.467	.001
	Aktiviteti ekonomik	-.433	.065	-.201	-6.618	.000
	Madhësia e ndërmarrjes	-.269	.048	-.163	-5.614	.000
a. Dependent Variable: LNProdhimi/Nr punonjësish						

Aneket

Modeli 3

Variables Entered/Removeda					
Model	Variables Entered		Variables Removed	Method	
1	Përdorimi i informacionit elektronik për zinxhirët e furnitorëve, Aktiviteti ekonomik, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Madhësia e ndërmarrjes, Përdorimi i paketës ERP, Moshë e ndërmarrjes, Përdorimi i pajisje portabël, LNPaga/ Nr punonjësish, Prezenca e faqes Web, Paketa CRM marketing, Të punësuar me njohuri TIK b		.	Enter	
a. Dependent Variable: LNProdhimi/ Nr punonjësish					
b. All requested variables entered.					
Model Summary					
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	
1	.639a	.408	.399	.83195	
a. Predictors: (Constant), Përdorimi i informacionit elektronik për zinxhirët e furnitorëve, Aktiviteti ekonomik, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Madhësia e ndërmarrjes, Përdorimi i paketës ERP, Moshë e ndërmarrjes, Përdorimi i pajisje portabël, LNPaga/ Nr punonjësish, Prezenca e faqes Web, Paketa CRM marketing, Të punësuar me njohuri TIK					
ANOVAa					
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F
1	Regression	358.872	11	32.625	47.136
	Residual	520.485	752	.692	
	Total	879.357	763		
a. Dependent Variable LNProdhimi/Nr punonjësish					
b. Predictors: (Constant), Përdorimi i informacionit elektronik për zinxhirët e furnitorëve, Aktiviteti ekonon punonjësish, Madhësia e ndërmarrjes, Përdorimi i paketës ERP, Moshë e ndërmarrjes, Përdorimi i pajisje p punonjësish, Prezenca e faqes Web, Paketa CRM marketing, Të punësuar me njohuri TIK					

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error			
1	(Constant)	2.663	.396		6.722	.000
	LN Paga/ Nr punonjësish	.868	.066	.422	13.171	.000
	LN Intenskapital/ Nr punonjësish	.145	.016	.276	9.353	.000
	Mosha e ndërmarrjes	.014	.005	.088	3.035	.002
	Aktiviteti ekonomik	-.518	.069	-.240	-7.525	.000
	Madhësia e ndërmarrjes	-.358	.052	-.216	-6.924	.000
	Prezenca e faqes Web	.333	.077	.139	4.296	.000
	Të punësuar me njohuri TIK	.019	.076	.008	.246	.806
	Përdorimi i paketës ERP	.102	.065	.047	1.553	.121
	Paketa CRM marketing	-.034	.087	-.012	-.388	.698
	Përdorimi i pajisje portabël	.193	.071	.084	2.703	.007
	Përdorimi i informacionit elektronik për zinxhirët e furnitorëve	-.056	.104	-.016	-.533	.594
a. Dependent Variable: LN Prodhimi/ Nr punonjësish						

Aneket

Modeli 4

Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Përdorimi i pajisje portabël, Mosha e ndërmarrjes, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Madhësia e ndërmarrjes, Aktiviteti ekonomik, LNPaga/ Nr punonjësish, Prezenca e faqes Web ^b		Enter

a. Dependent Variable: LNProdhiimi/ Nr punonjësish

b. All requested variables entered.

Model Summary

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.638 ^a	.406	.401	.83136

a. Predictors: (Constant), Përdorimi i pajisje portabël, Mosha e ndërmarrjes, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Madhësia e ndërmarrjes, Aktiviteti ekonomik, LNPaga/ Nr punonjësish, Prezenca e faqes Web

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	358.268	7	51.181	74.052	.000 ^b
	Residual	523.205	757	.691		
	Total	881.474	764			

a. Dependent Variable LNProdhiimi/ Nr punonjësish

b. Predictors: (Constant), Përdorimi i pajisje portabël, Mosha e ndërmarrjes, LNIntenskapital/Nr punonjësish, Madhësia e ndërmarrjes, Aktiviteti ekonomik, LNPaga/ Nr punonjësish, Prezenca e faqes Web

Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	2.618	.372		7.044	.000
	LNPaga/ Nr punonjësish	.878	.063	.427	13.836	.000
	LNIntenskapital/Nr punonjësish	.146	.015	.278	9.454	.000
	Mosha e ndërmarrjes	.014	.005	.090	3.085	.002
	Aktiviteti ekonomik	-.512	.066	-.237	-7.728	.000
	Madhësia e ndërmarrjes	-.355	.050	-.214	-7.139	.000
	Prezenca e faqes Web	.333	.075	.139	4.426	.000
	Përdorimi i pajisje portabël	.201	.069	.087	2.925	.004

a. Dependent Variable: LNProdhiimi/ Nr punonjësish

RASTI I NDËRTIMIT NË SHQIPËRI: LIDHJA ME SEKTORË TË TJERË DHE NDIKIMI NË PBB

Stejsi Mici, Instituti i Statistikave
smici@instat.gov.al

Abstrakt

Qëllimi i kësaj teze është të studiojë rastin e ndërtimit në Shqipëri dhe lidhjen me sektorë të tjerë të ekonomisë. Vëzhgimi do të bëhet përmes përdorimit të testeve të ndryshme statistikore të marrëdhënies së kësaj industrie me sektorë të tjerë të ekonomisë. I gjithë studimi është organizuar në një mënyrë ku raste nga studime të tjera të disponueshme për vendet e tjera merren në konsideratë në mënyrë që lexuesi të ketë një pamje më të qartë. Kohët e fundit është parë që, industria e ndërtimit ka pasur një lulëzim në vendin tonë dhe për këtë arsye kjo temë konsiderohet interesante për tu marrë në studim. Hulumtime të ndryshme kanë dalë në përfundime se industria e ndërtimit është një variabël domethënëse që siguron kontribut të madh në rritjen e ekonomisë pasi ofron hapësirë për të përmirësuar infrastrukturën për zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve të tjerë ekonomikë. Shqipëria klasifikohet në një vend në zhvillim, që do të thotë se ky studim do të shihet gjithashtu në këtë prizëm. Për të arritur qëllimin e hulumtimit, seritë kohore që fillojnë nga viti 2008 merren si të dhëna nën vëzhgim mbi të cilat do të kryhen testet statistikore. Shkakësia do të testohet përmes zbatimit të "Modelit Ekonometrik të Shkaktarisë Granger" e cila është një metodë sasiore për studimin e Industrisë së Ndërtimit në Shqipëri.

Stacionariteti i serive kohore do të kryhet përmes përdorimit të "testit Dickey Fuller". Nga këto teste, do të jetë e mundur që të evidentohet nëse sektorë të ndryshëm ekonomikë në Shqipëri kanë efekte shkakësore me njëri-tjetrin dhe nëse

po, nëse kjo marrëdhënie është njëkahëse apo dy-kahëse. Duhet përmendur që këto teste studiojnë marrëdhëniet shkakësore vetëm në periudhën afatshkurtër. Disa teste të tjera statistikore kryhen në seri kohore në mënyrë që të jenë të përshtatshme për zbatimin e modelit ekonometrik Test rrënjë njësie e palëvizshme (testi Dickey Fuller) Testimi i autokorrelacionit (Ljung Box, ACF, PCF) – SPSS.

Fjalë Kyçe:

"Granger Model", Analizë Deskriptive, Correlation, co-linearity "IN Industri Ndertimi"
Stacionaritet, Autokorrelcation, Shkakësi, Signifikancë.

1. HYRJE

Industria e ndërtimit është një nga industritë më të rëndësishme që ka një të rol të konsiderueshëm në ekonominë e një vendi. Kjo industri po ndikon në jetën tonë në një mënyrë të drejtpërdrejtë duke e bërë atë më të lehtë përmes rrugëve, shkollave, spitaleve, ndërsa në mënyrë indirekte, ka krijuar mundësi të reja punësimi të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë së një kombi (Thomas Metcalf, 2009). Vendet në zhvillim kanë tendencë të kenë një fokus më të gjerë në këtë industri për shkak të nevojës jetësore për të siguruar komoditete në stilin e përditshëm të jetës. (George Ofori, 2007). Ndërsa i referohemi vendeve në zhvillim, Shqipëria është gjithashtu një nga këto vende ku është industria e ndërtimit konsiderohet një kontribues i madh në ekonomi i cili siguron një hapësirë të përshtatshme për zhvillimin e sektorëve të tjerë si: tregtia, shërbimet, etj. Përveç vlerës së shtuar që shkakton kjo industri në total, menaxhimi i rrezikut është një faktor kryesor që kompanitë duhet të konsiderojnë në projektet e tyre në mënyrë që të shmangin dështimet dhe të arrijnë suksesin e projektit, në mënyrë që të mund të arrijmë sukses në ekonominë e përgjithshme. Qëllimi i këtij artikulli kërkimor është të identifikojë marrëdhënien e Industrisë së Ndërtimit në ekonominë shqiptare të përfaqësuar nga PBB dhe marrëdhënien (shkak-pasojë) me sektorë të tjerë në ekonomi, përmes krahasimit me literaturën ekzistues në lidhje me këtë temë. Kjo marrëdhënie do të shqyrtohet duke studiuar nga afër marrëdhëniet e PBB-së (Prodhimi i Brendshëm Bruto) në sektorë të ndryshëm të ekonomisë me industrinë e ndërtimit. Pra me fjalë të tjera, ky artikull kërkimor do të studiojë hipoteza të ndryshme si argument i pyetjes kërkimore: “A ekziston një marrëdhënie shkakësore midis Industrisë së Ndërtimit dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto në Shqipëri? Lidhja me sektorë të tjerë të ekonomisë.”

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë në mënyrë të detajuar marrëdhënien e Industrisë së ndërtimit me PBB e sektorë të tjerë të ekonomisë. Gjatë periudhës së tranzicionit, ka ndodhur një “boom” në këtë industri dhe si rezultat, një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve i është orientuar ndërtimit.

Në mënyrë që të arrihet qëllimi i përcaktuar për këtë artikull shkencor, janë vendosur objektivat e mëposhtëm:

- 1- Evidentimi nëse ekziston një lidhje e pastër shkak-pasojë (kauzale) midis industrisë së ndërtimit dhe rritjes ekonomike të vendit.

- 2- Evidentimi nëse ekziston një marrëdhënie si më sipër midis kësaj industrie dhe sektorëve të tjerë në Ekonomi.

- 3- Krahasimi i literaturës në lidhje me pikat e mësipërme me gjetjet e hulumtimit.

- 4- Analiza e gjetjeve. A ekziston kjo marrëdhënie?

2. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur përfaqësohet nga metodat kryesore statistikore dhe ekonometrike në mënyrë që të kombinohen variablat kryesorë që supozohet të kenë marrëdhënie me industrinë e ndërtimit. Qëllimi është identifikimi i ndërlidhjes së shkak - pasojës (kauzalitetit) midis industrisë së ndërtimit dhe ekonomisë në Shqipëri e cila përfaqësohet nga “Prodhimi i Brendshëm Bruto” sikurse dhe me sektorë të tjerë në ekonomi si: Shërbime, Miniera dhe Gurorë, Turizëm, Bujqësi, etj. Duke përdorur në periudhë kohore dhjetë vjeçare (2008-2018). Modeli më i mirë për të identifikuar shkakësinë është “Modeli Granger” i cili është prezantuar më 1969 dhe përdoret gjithashtu për përcaktimin e bashkë-integritit të variablave (BentSorenson, 2005).

Ky model do të përdoret për të identifikuar:

- a) Marrëdhënien shkakësore e agregatit të PBB-së dhe IN-së.

- b) Marrëdhënien shkakësore me sektorët e tjerë ekonomikë.

Sipas Dorward, F. Akintoye (2000), ekzistojnë modele më komplekse dhe më të gjera por ato konsiderohen të vështira për tu përshtatur në praktikë dhe për këtë arsye, shpjegimi i variablit të varur të shtrirë në një seri kohore bëhet përmes programeve statistikore të tilla si: SPSS.

Në mënyrë që të mos ndikojë në rezultatin e modelit të zgjedhur, një analizë deskriptive, testet e korrelacionit, dhe studimi i kolinearitetit midis variablave dhe mbetjeve (residuals), do të ndërmerren si teste përpara fillimit të analizës.

- a) Testimi i stacionaritetit të serive kohore.

“Stacionariteti” është një nga provat më të rëndësishme kur kemi të bëjmë me seri kohore sepse është më e lehtë për tu bërë analiza me modele stacionare pasi ato nuk kanë efekt sezonal ose trend (Analitikë, 2018).

Kjo mund të identifikohet në disa mënyra:

“Augmented Dickey Fuller Test” - Unit root test ose “Testi rrënjësor i njësisë statistikore” përmes kryerjes së hipotezave dhe përfundimit bazuar në vlerën p:

Hipoteza zero (H_0) - seri kohore stacionare

(H_1) – refuzo H_0 .

Stacionariteti mund të identifikohet lehtësisht edhe nga modeli Gaussian (Histogram) nëse seria kohore ka një

Shpërndarje normale ose jo (Normal distribution) – Bell shape.

Unit root test ose “Test rrënjësor i njësisë statistikore” - Nëse ekziston një tendencë që vlerat të varjojnë rreth mesatares së saj. Seritë kohore janë “të palëvizshme” ose Stacionare ndërsa nga ana tjetër në serite kohore “jo-stacionare”, varianca dhe mesatarja ndryshojnë në periudha të ndryshme kohore për arsye të tilla si: ndryshimet në kurset e këmbimit ose inflacioni. Në këto raste, të dhënat jostacionare do të shndërrohen në stacionare përmes përdorimit të programit.

b) Testimi i autokorrelacionit

Autokorrelacioni është një çështje tjetër e rëndësishme kur studiojmë vlerat historike në seritë kohore sepse prezenca e tij shkakton probleme në procesin e analizës së të dhënave (Carmen M. Benkovitz, 1991). “Durbin Watson” është një test i përdorur për të gjetur nëse autokorrelacioni në mbetjet (residuals) e serive kohore është i pranishëm. Ky test statistikor aplikohet tek mbetjet nga regresionet lineare (least square regressions) duke ngritur hipotezën:

Mbetjet (residuals) nuk janë të ndërlidhura në seri, kundër refuzimit të kësaj hipoteze që do të thotë se seritë ndjekin një proces autoregresiv. Për shkak të disponueshmërisë nëse programet statistikore posedojnë këtë test ose jo, autokorrelacioni mund të provohet edhe nga modelet ARIMA: ACF, PACF ku rëndësia statistikore “statistical significance”: (studimi i vlerës p) mund të identifikohet nga “Ljung-Box statistic” në tabelat e SPSS.

2.1 Kufizimet kërkimore

Kjo temë kërkimore pati një numër të konsiderueshëm kufizimesh. Përsa i përket metodës statistikore të zgjedhur për analizën e të dhënave, ekziston një qasje e kufizuar e disa nga variablat kryesorë. Lidhur me metodologjinë dhe testet që do të ndërmerren për të arritur në konkluzione, “Testi Durbin Watson” nuk është i mundur të përdoret për shkak të paarritshmërisë së një programi statistikor që e siguron atë. Një tjetër gjë për t’u përmendur është se në përgjithësi, ka shumë burime të besueshme për rishikimin e literaturës në lidhje me temën e studimit në terma të përgjithshëm, por ka disa kufizime në përshtatjen e kësaj teme specifike për Shqipërinë. Meqenëse nuk ka kërkime ose botime nga burime të besueshme që ofrojnë informacion mbi fenomenin “shkak-pasojë” midis sektorëve ekonomikë, është përdorur testi “GRANGER CAUSALITY” në mënyrë

që të analizojë ndërlidhjen e prodhimit të industrisë së ndërtimit dhe sektorëve të tjerë ekonomikë.

3. RISHIKIMI I LITERATURËS

Pyetja kërkimore e studimit përfshin: Analiza e marrëdhënies që ka industria e ndërtimit në ekonomi. Sfondi teorik i tezës dhe literatura e saj do të merret kryesisht nga librat akademikë si revista ekonomike, artikuj në gazeta dhe kërkime të tjera të ngjashme shkencore dhe aplikimi i testeve. Në mënyrë që të arrihet në përfundime zhvillohen mbi metodologjitë e zgjedhura dhe më pas bëhet një krahasim me literaturën e disponueshme.

Teoritë në lidhje me rritjen dhe zhvillimin

GDP_TOT does not Granger Cause ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES does not Granger Cause GDP_TOT	34	1.02170 1.57720	0.4153 0.2113
INFORMATION_AND_COMMUNICATION does not Granger Cause ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES does not Granger Cause INFORMATION_AND_COMMUNICATION	34	0.41495 1.60693	0.7962 0.2036
RETAIL__TRANSPORT__ACCOMMODATION_ACTIVITIES_AND_SERVICE does not Granger Cause ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES does not Granger Cause RETAIL__TRANSPORT__ACCOMMODATION_ACTIVITIES_AND_SERVICE	34	0.26350 5.16352	0.8986 0.0036
TOTAL_INDUSTRY does not Granger Cause ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES ARTS__ENTERTAINMENT_OTHER_SERVICES does not Granger Cause TOTAL_INDUSTRY	34	1.48688 0.71892	0.2362 0.5870
FINANCIAL_ACTIVITIES_AND_INSURANCE does not Granger Cause EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES does not Granger Cause FINANCIAL_ACTIVITIES_AND_INSURANCE	34	1.69119 0.60003	0.1835 0.8661
GDP_TOT does not Granger Cause EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES does not Granger Cause GDP_TOT	34	1.32711 0.60065	0.2873 0.8656
INFORMATION_AND_COMMUNICATION does not Granger Cause EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES does not Granger Cause INFORMATION_AND_COMMUNICATION	34	0.64467 1.34858	0.8358 0.2799
RETAIL__TRANSPORT__ACCOMMODATION_ACTIVITIES_AND_SERVICE does not Granger Cause EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES does not Granger Cause RETAIL__TRANSPORT__ACCOMMODATION_ACTIVITIES_AND_SERVICE	34	1.51247 1.04315	0.2288 0.4049
TOTAL_INDUSTRY does not Granger Cause EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES EDUCATION__SOCIAL_AND_HEALTH_ACTIVITIES does not Granger Cause TOTAL_INDUSTRY	34	0.48086 5.11932	0.7495 0.0037

Grafiku 4: Transformimi I serive kohore në logaritmikë (stacionarë)



Grafiku 5: Seria kohore e PBB perpara transformimit ne logaritmik




Tabela 4: Përshkrimi i modelit ARIMA (1, 0, 0) për serinë kohore të PBB- përpara transformimit të tij në logaritmik.

Model Description

			Model type
Model ID	GDP TOT	Model_1	ARIMA(1,0,0)


Model Statistics

Model	Number of Preditors	Model Fit statistics		Ljung-Box Q (18)			Number of Outliers
		Stationary R-squared	Normalized BIC	Statistics	DF	Sig.	
GDP TOT-Model_1	0	.757	15.752	20.914	17	.230	0


ARIMA Model Parameters

				Estimate	SE	t	Sig.
GDP TOT-Model_1	GDP TOT	No Transformation	Constant	37435.890	2978.385	12.569	.000
			AR Lag 1	.904	.065	13.943	.000

Grafiku 6: Seria kohore përpara transformimit logaritmik




Grafiku 7: Seria kohore e PBB pas transformimit në logaritmik



Grafiku 8: PACF (partial autocorrelation function)

Seritë janë randomly distributed (shpërndarje normale).



ADF - Testi logaritmik (Augmented Dickey-fuller) logaritmik në eviews

*Rezultatet për serine kohore të PBB

Null Hypothesis: LNGDP TOT has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-1.887529	0.3343
Test critical values:		
1% level	-3.621023	
5% level	-2.943427	
10% level	-2.610263	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(LNGDP TOT)
Method: Least Squares
Date: 04/19/19 Time: 11:40
Sample (adjusted): 2009Q2 2018Q2
Included observations: 37 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
LNGDP TOT(-1)	-0.138015	0.073119	-1.887529	0.0674
C	1.441596	0.766802	1.880009	0.0685
R-squared	0.092389	Mean dependent var		-0.005649
Adjusted R-squared	0.066457	S.D. dependent var		0.061509
S.E. of regression	0.059430	Akaike info criterion		-2.755497
Sum squared resid	0.123617	Schwarz criterion		-2.668421
Log likelihood	52.97670	Hannan-Quinn criter.		-2.724799
F-statistic	3.562766	Durbin-Watson stat		2.371514
Prob(F-statistic)	0.067404			

*Rezultatet për serine kohore të Industrisë Ndërtimit

Null Hypothesis: LNCONSTRUCTION has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=9)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-2.137451	0.2319
Test critical values:		
1% level	-3.621023	
5% level	-2.943427	
10% level	-2.610263	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(LNCONSTRUCTION)
Method: Least Squares
Date: 04/19/19 Time: 11:44
Sample (adjusted): 2009Q2 2018Q2
Included observations: 37 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
LNCONSTRUCTION(-1)	-0.159725	0.074727	-2.137451	0.0396
C	1.668155	0.783236	2.129825	0.0403
R-squared	0.115462	Mean dependent var		-0.005846
Adjusted R-squared	0.090190	S.D. dependent var		0.061412
S.E. of regression	0.058577	Akaike info criterion		-2.784416
Sum squared resid	0.120094	Schwarz criterion		-2.697339
Log likelihood	53.51169	Hannan-Quinn criter.		-2.753717
F-statistic	4.568696	Durbin-Watson stat		2.332845
Prob(F-statistic)	0.039625			

IMPAKTI SOCIAL DHE EKONOMIK I FENOMENIT TË 'IKJES SË TRURIT' NË VENDET NË ZHVILLIM

Elma Çali, Instituti i Statistikave
ecali@instat.gov.al

Sokrat Palushi, Instituti i Statistikave
spalushi@instat.gov.al

Abstrakt

Përpos të gjithë problematikave me të cilat jemi përballur gjerësisht në procesin e globalizimit, një fenomen i quajtur "ikja e trurit" (brain drain) është vazhdimisht në qendër të vëmendjes së politikave të zhvillimit të vendeve. Vendet në zhvillim janë prekur më gjerësisht nga ky fenomen, për shkak të pasojave negative që mund të ndikojnë në ekonominë e tyre. Sidoqoftë, ndikimi i parë i kësaj lëvizje të kapitalit njerëzor daton në vitet 1960, për të përshkruar imigrimin në shkallë të gjerë të shkencëtarëve britanikë në Shtetet e Bashkuara (Royal Society 1963). Ky artikull synon të analizojë, ndikimin negativ që gjenerohet në ekonominë e vendeve në zhvillim, në një situatë shqetësuese kur dy të tretat e emigrantëve me aftësi të larta vijnë nga vendet në zhvillim dhe në tranzicion. Të dhënat tregojnë se mesatarisht, niveli i ikjes së trurit që maksimizon akumulimin e kapitalit njerëzor në një vend në zhvillim, është rreth 10%. Ky nivel ndryshon në vende të ndryshme, varësisht nga madhësia, vendi, gjuha dhe politikat e tyre publike. Rezultatet përfundimtare pritet të vlerësojnë faktin që ikja e trurit sjell një rënie ekonomike duke ulur edhe më shumë mirëqenien e kombeve më të varfra. Ky fenomen shkakton probleme komplekse shoqërore që e lënë vendin të pazhvilluar nga ana intelektuale dhe teknologjike, si dhe thëllon edhe më shumë hendekun midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.

Fjalët kyçe:

Ikja e trurit, migrimi, zhvillim i ulët teknologjik dhe intelektual, rritja ekonomike

1. HYRJE

Qëllimi i këtij artikulli është pasqyrimi i një analize të fenomenit të “ikjes së trurit” dhe ndikimi që ky fenomen ka në vendet në zhvillim. “Ikja e trurit” i referohet rritjes së konsiderueshme të migrimit të intelektualëve të aftë apo kapitalit njerëzor të mirë-arsimuar, profesionistëve dhe të fuqisë punëtore të kualifikuar me anë të lëvizjes së lirë të punës nga vendet në zhvillim në vendet e zhvilluara, për një pagë apo kushte më të mira të jetesës.

Nga njëra anë vendi i zhvilluar (vendi pritës) fiton aftësi dhe burime njerëzore shtesë nga migrimi ndërsa vazhdon të bëhet më i pasur. Nga ana tjetër, vendi në zhvillim (vendi dërgues) humbet fuqi punëtore dhe kapital njerëzor shumë të aftë dhe në mënyrë të pashmangshme bëhet i varfër. Në këtë artikull do të shqyrtohet fillimisht rishikimi i literaturës, fillesat e tij dhe argumentat pro dhe kundër qasjes së përkrahësve të ekonomisë së re të emigrimit. Më pas do të shqyrtohet balanca mes humbjeve dhe përfitimeve që vendet kanë nga fenomeni i “ikjes së trurit” dhe do të evidentohet rasti i Shqipërisë si një vend në zhvillim i ndikuar nga ky fenomen. Në përfundim të artikullit do të trajtojmë politikat e nevojshme për të “zbutur” ndikimin negativ që ka ky fenomen dhe konkluzionet përmbyllëse të artikullit.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

Për vite me rradhë ka patur një diskutim të gjerë mbi efektet në ekonomi të migrimit të kualifikuar për vendet e origjinës. Kjo çështje është diskutuar për gati pesëdhjetë vjet. Gjatë kësaj periudhe, shumica e studiuesve (p.sh. Bhagwati and Hamada 1974, Portes, 1976) dolën në përfundimin se migrimi i kualifikuar është i dëmshëm për vendet e origjinës, ndërsa ekonomitë pritëse përfitojnë nga hyrja e fuqisë punëtore të kualifikuar. Kështu nocioni i “ikjes së trurit” - i dëmshëm për ekonomitë në zhvillim dhe “fitimi i trurit” - fitimprurës për vendet e zhvilluara u krijua dhe është akoma i pranishëm edhe në ditët e sotme.

Sidoqoftë, në mes të viteve 1990, u bë i dukshëm një varg i ri kërkimesh mbi migracionin e burimeve njerëzore të kualifikuar. Teoricienët e ekonomisë së re të emigrimit të fuqisë punëtore argumentuan se ikja e trurit nuk duhet të jetë e dëmshme për vendet e origjinës. Në rrethana të caktuara, migrimi i profesionistëve nga ekonomitë në zhvillim mund të jetë në fakt një “bekim”, dhe fitimet e mundshme mund të jenë më të larta se kostot. Ekonomistët (të tillë si Mountford, 1997, Beine et al., 2001 dhe 2003, Stark, 2005) përkrahës të ekonomisë së re të emigrimit ri-dimensionuan diskutimin mbi pasojat ekonomike të migrimit të kualifikuar. Sidoqoftë, pikëpamjet e tyre optimiste për ikjen e trurit kanë hasur shpesh në kritika të forta.

Së pari, ithtarët e qasjes neoklasike argumentuan se migrimi i kualifikuar është i favorshëm në nivelin ndërkombëtar: si për vendet e origjinës ashtu edhe për vendet pritëse. Përfitimet kryesore nga ky proces lidhen me përparimet në fushën e shkencës dhe teknologjisë për ekonomitë në zhvillim dhe ato të zhvilluara (Grubel dhe Scott, 1966).

Së dyti, studiuesit nga qasja e sistemeve botërore pohuan se ikja e trurit është në një masë të madhe e dëmshme, të paktën për vendet dërguese. Ithtarët e teorisë së sistemit botëror e kanë perceptuar migrimin e individëve shumë të kualifikuar si një manifestim të prapambetjes ekonomike të vendeve në zhvillim (Portes, 1976).

Fluksi ndërkombëtar i punës së kualifikuar ka qenë faktori kryesor për rritjen e çekuilibrave ekonomikë dhe uljen e potencialit ekonomik të vendeve me të ardhura të ulëta, veçanërisht kur përkthehet në nivelet e produktivitetit (Kannappan, 1968).

Ky proces shihet si i diskutueshëm në aspektin etik të fenomenit që vendet jo shumë të zhvilluara (vendet dërguese) përballojnë koston e arsimimit të emigrantëve potencialë, ndërsa vendet pritëse marrin përfitimet e këtyre shpenzimeve pasi vendet e varfra kanë financuar në një masë të madhe arsimimin e emigrantëve të kualifikuar. Kështu që ikja e trurit mund të konsiderohet si një subvencion i kombeve të pasura nga të varfërit (Massey et al., 1998).

Aspektet negative të ikjes së trurit për vendet në zhvillim janë përshkruar gjithashtu nga Bhagwati dhe Hamada (1974), ku fokusi ishte në aspektin social (d.m.th. eksternalitete të forta në prodhimin e siguruar nga punëtorë të kualifikuar) dhe kostot fiskale (të ardhurat nga taksat e paracaktuara) të emigracionit.

Ikja e trurit gjithashtu shkaktoi shtrembërime në tregjet lokale të punës, duke rritur papunësinë dhe ulur PBB-në e mundshme. Për të kompensuar humbjet e tilla për ekonomitë e vendit, Bhagwati propozoi të taksonte të ardhurat (d.m.th. “Bhagwati Tax”) e emigrantëve të kualifikuar. Të ardhurat nga “Bhagwati Tax” duhet të kanalizoheshin përsëri në vendet e emigrimit përmes programeve të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (Bhagwati, 1976). Ky diskutim midis qasjes optimiste dhe pesimiste vazhdoi deri në vitet 1980, pasi shumë analiza mbi fenomenin e ikjes së trurit ranë poshtë si pasojë e mungesës së të dhënave të besueshme dhe sistematike. Kështu që analiza mbi migracionin e burimeve njerëzore të kualifikuara dhe efektet e saj ekonomike ishin thjesht teorike. Analiza teorike mbi migracionin e burimeve njerëzore të kualifikuara është rivitalizuar në vitet 1990 brenda kornizës së rritjes endogjene.

Miyagiwa (1991) nënvizoi faktin se ikja e trurit rrit të ardhurat kombëtare dhe kthimet në arsim në vendet pritëse, por nga ana tjetër ulë prirjen për të studiuar dhe të ardhurat në familje. Haque dhe Kim (1995) argumentuan se ikja e trurit ngadalëson akumulimin e kapitalit njerëzor në ekonomitë e vendit, duke kontribuar kështu në uljen e përhershme të shkallës së rritjes së ekonomisë.

Por, vlera kryesore e teorisë së ekonomisë së re të emigrimit ishte analiza empirike. Falë punëve pioniere të Carrington dhe Detragiache (1998), dhe përpjekjeve vijuese të Docquier dhe Marfouk (2005), Dumont dhe Lemaître (2005) dhe Beine et al. (2006), u krijuan baza të dhënash të harmonizuara të niveleve të migracionit të burimeve njerëzore të kualifikuar, modelet teorike u testuan dhe disa nga efektet pozitive të ikjes së trurit u verifikuan (të paktën në një farë mase). Referuar teorisë së ekonomisë së re të emigrimit, shumë autorë nuk ndajnë pikëpamje optimiste. Kundërshtari më i rëndësishëm i kësaj qasjeje është Maurice Schiff (2005). Ai argumenton se shumica e supozimeve të kësaj qasjeje të re janë joreale. Gjithashtu, Ricardo Faini (2002) ka gjetur pak mbështetje për ekzistencën e efektit të arsimit të detyruar. Ai aplikoi analizën e regresionit mbi normat e regjistrimit në grupin e 50 vendeve dhe gjeti që nivelet e migracionit ishin të lidhura negativisht me investimet arsimore, duke përjashtuar regjistrimin në nivelin sekondar. Rezultate mjaft të ngjashme u morën nga Checchi et al. (2007). Ata zbuluan gjithashtu që nivelet e migrimit janë të lidhura negativisht me normat e regjistrimit. Sidoqoftë, ata pretendojnë se kjo është shkaktuar nga ndikimi i ikjes së trurit në popullatën e brendshme.

Në nivelin makro, efekti i arsimit të detyruar është konfirmuar vetëm nga autorët e teorisë së ekonomisë së re për ikjen e trurit (Beine et al., 2003) dhe së fundmi, nga Brücker et al. (2008). Siç do të pretendohet më vonë, këto analiza të veçanta janë paragjykuar nga fakti se përbërja demografike e popullsisë në vendet në zhvillim nuk është marrë parasysh. Për më tepër, efekti i arsimit të detyruar është vënë në dyshim edhe në nivelin mikro. Kangasniemi et al. (2004) kanë anketuar mjekët jashtë shtetit që punojnë në Mbretërinë e Bashkuar. Shumica e të anketuarve argumentuan se perspektivat e migracionit nuk luanin asnjë rol në vendimet mbi arsimimin e tyre.

3. HUMBJET DHE PËRFITIMET E VENDEVE NGA FENOMENI I “IKJES SË TRURIT”

“Ikja e trurit” mbetet ende shumë shqetësues, por studimet esenciale mbi këtë fenomen datojnë që në vitin 1960, kur pati një numër të lartë emigrimi të përhershëm të kapitalit njerëzor të mirë-arsimuar dhe profesionistëve si shkencëtar apo hulumtues nga vendet në zhvillim, duke

dëmtuar dhe penguar zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendeve të tyre. Periudha e globalizmit ka krijuar mundësi të reja për kapitalin njerëzor, ku ky kapital ka mundësi të shpërblehet financiarisht më mirë (paga më të larta) që përkthehet në një mirëqenie më të lartë, si dhe vlerësohet më shumë në vendet ekonomisht shumë të fuqishme dhe të zhvilluara. Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara kanë qënë historikisht një destinacion i preferuar për punëtorët e kualifikuar, ku më së shumti kjo e fundit ka tërhequr një numër të konsiderueshëm studentësh nga e gjithë bota. Këto vende i kanë ofruar atyre mundësi specializimi të mëtijshme dhe më pas përfshirjen e tyre në ndërmarrjet shtetërore dhe privatë të këtyre vendeve duke kontribuar për zhvillimin ekonomik të tyre.¹ Referuar efekteve negative të “ikjes së trurit” mund të listojmë një sërë efektsh esenciale që thellojnë edhe më tepër problematikat e vendeve në zhvillim ku mund të përmendim:

- rënien neto në stokun e kapitalit njerëzor, veçanërisht i atyre me eksperiencë të vlefshme profesionale;
- rënien ekonomike dhe produktivitetin si pasojë e stokut të ulët të kapitalit njerëzor;
- humbjet fiskale të investimeve të mëdha të bëra për subvencionimin e arsimit;
- remitancat nga migracioni i personave të kualifikuar mund të pësojnë rënie pas disa kohësh;
- rënien e konsiderueshme në cilësinë e shërbimeve në fushën e shëndetësisë dhe arsimit;
- studentët e financur nga qeveria gjatë periudhës së studimeve janë një pjesë kryesore e kapitalit njerëzor të larguar nga vendet e tyre;
- mundësitë për lëvizje afatshkurtër kufizohen seriozisht nga politikat e imigracionit të vendeve të zhvilluara;
- rritjen e pabarazisë së të ardhurave në vendet e origjinës.

Pas evidentimit të një sërë aspektesh negative, kemi shtruar një pyetje: A ka fenomeni i “ikjes së trurit” vetëm efekte negative, apo mund të evidentohen dhe anë pozitive të këtij fenomeni?

Sigurisht, të vendosura në një balancë efektet negative janë më të mëdha se ato pozitive, por absolutisht mund të evidentohen dhe anë pozitive të tij. Këtu mund të theksojmë:

- hyrja e remitancave dhe valutave të huaja;
- stimul për nxitjen e investimeve në arsimin e vendeve të origjinës dhe investimeve individuale të kapitalit njerëzor;
- kthimi i personave të kualifikuar rrit kapitalin njerëzor lokal, rrit transferimin e aftësive dhe rrit lidhjet me rrjetin e huaj;
- investime në transferimin e teknologjisë dhe kapitalit sipërmarrës;
- “qarkullimi i trurit” promovon integrimin në tregun global.

¹ Nedeljkovic, V., “Brain Drain in the European Union: Facts and Figures”, Rethink Education Working Paper, No.4, Bidding Europe.

Një shembull të këtij fenomeni e hasim dhe në shtetet e Bashkimit Evropian (BE), ku për shkak të lëvizjes së lirë të shtetasve brenda vendeve të BE-së, kemi një rritje të lëvizjeve migratore dhe një rritje të kapitalit njerëzor të kualifikuar. Megjithatë, në vendet në zhvillim, kostoja është edhe më e lartë duke e patur të vështirë gjetjen dhe zëvendësimin e punëtorëve të kualifikuar.


Megjithatë, në përfundim mund të themi se edhe pse mund të evidentohen anë pozitive të largimit të trurit nga vendi i origjinës në një periudhë afatgjatë, në çdo rast humbja e individëve të kualifikuar dhe të mirë-arsimuar ndikon në zhvillimin social – ekonomik të një vendi, pasi këta individë janë forca drejtuese e tij.

4. FENOMENI I “IKJES SË TRURIT” NË VENDET NË ZHVILLIM: RASTI I SHQIPËRISË

Fenomeni i “ikjes së trurit”, tashmë është një fakt real dhe i matshëm dhe për vendet në zhvillim. Globalizimi ka bërë të mundur që të sheshohet diferenca në profesionalizëm dhe në njohuri midis vendeve të ndryshme duke bërë të mundur ushtrimin e profesioneve pa asnjë vështirësi për personat që vijnë nga vendet në zhvillim. Kështu viteve të fundit vërehet gjithnjë e më shumë një trend ku profesionistët në të gjitha profesionet me nivel të lartë kualifikimi kanë tendencën që të tentojnë për t’u punësuar në shtetet e Bashkimit Evropian ose në Mbretërinë e Bashkuar, Kanada apo dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fakti që vendet e zhvilluara të sipërpërmendura po përballen me problemin e plakjes së popullsisë ka ndikuar në lehtësimin e proceseve të pranimit dhe aplikimit për t’u bërë pjesë e krahut të punës së vendeve të zhvilluara.

Në grafikun 1, paraqitet numri i studentëve që studiojnë jashtë vendit sipas vendit të origjinës. Duke bërë një analizë krahasuese me shtetet e rajonit në lidhje me numrin e studentëve që studiojnë jashtë, rezulton se Shqipëria renditet e para më një numër përkatësisht 18,181 student, e ndjekur nga Serbia me 15,749 student, pastaj Bosnia/Herzegovina me 15,399. Fakti që numri i studentëve shqiptar që studiojnë jashtë është më i larti në rajon krahasuar dhe në raport me popullsinë, duhet parë në të dyja anët e medaljes. Nga njëra ana numri i lartë i studentëve shqiptar që studiojnë jashtë mund të shikohet si dukuri pozitive për pjesën e përvetësimit të njohurive në fushat respektive ku ato studiojnë, por nga ana tjetër mund të shikohet dhe si një indikator matës për mosbesueshmërinë e studentëve për cilësinë e universiteteve shqiptare. Gjithashtu duhet të analizohet dhe fakti tjetër që këta student që studiojnë jashtë a kanë dëshirë dhe vullnet për t’u kthyer në Shqipëri?


Grafiku 1: Numri i studentëve që studiojnë jashtë vendit sipas vendit të origjinës për vitin akademik 2019-2020



Burimi : Global Flow of Tertiary-Level Students (2020)

Duke u bazuar në publikimin e fundit të Unesco-s për vitin 2020, në grafikun 2 janë paraqitur disa nga destinacionet kryesore të studentëve shqiptar jashtë vendit. Shohim se destinacioni i parë i studentëve shqiptar është Italia e ndjekur nga Greqia, kjo si rezultat i faktit që janë shtete kufitare dhe për këtë arsye mund të shikohen si opsione të mira për shkak të lehtësirave që ofrojnë; si njohja paraprake e gjuhës apo kulturës, të pasurit e ndonjë familjari apo të njohuri. Në vend të tretë renditet Gjermania, duke filluar nga fundi i vitit 2014 e deri tani mund të themi që rritja e numrit të studentëve që zgjedhin Gjermaninë si destinacion për të studiuar vjen nga politika e jashtme që ndjek ky vend duke ofruar kurse të gjuhës gjermane në Shqipëri kryesisht për studentë të fushave mjeksore. Destinacione të tjera janë Turqia, SHBA-ja, Franca, Austria etj.

Grafiku 2: Destinacionet kryesore të studentëve shqiptar




Burimi : Llogaritjet e autorëve, Unesco (2020)

Shqipëria në periudha të ndryshme historike ka pasur valë migracioni. Po të marrim në analizë periudhën e pas viteve 90’ deri më sot kemi disa periudha kohore ku valët e migracionit kanë qenë masive. Janë kryesisht disa periudha kryesore kur emigracioni ka arritur pikat më të lartë. Me ndryshimet politike të viteve 90’ ishte vala e parë e migracionit ku kjo periudhë la jo pak gjurmë në ndryshimet demografike të numrit të popullsisë së Shqipërisë. Periudha e luftës në Kosovë në vitet 99’

ndikoi gjithashtu në shtimin e numrit të personave që u larguan nga Shqipëria duke u paraqitur në shtetet ku u zhvendosën si shtetas kosovar. Me liberalizimin e vizave numri i shtetasve shqiptar që po largoheshin nga Shqipëria ishte gjithnjë e më shumë në rritje duke vazhduar dhe deri në ditët e sotme. Indikator matës për pjesën e “ikjes së trurit” është dhe krahasimi i flukseve migratore. Krahasimi i flukseve migratore ndihmon në evidentimin e emigracionit neto. Migracioni neto shprehet si diferenca midis numrit të emigrantëve dhe numrit të imigrantëve. Referuar dhe publikimit të fundit të INSTAT, “Diaspora e Shqipërisë në Shifra” (2020) në grafikun 3 paraqitet migracioni neto i shprehur nga numri i emigrantëve dhe i imigrantëve.

Grafiku 3: Numri i emigrantëve, imigrantëve dhe migracioni neto



Burimi: Diaspora e Shqipërisë në Shifra, INSTAT (2020)

Siç shikohet dhe nga grafiku 3, me liberalizimin e vizave në vitin 2011, migracioni neto ka qenë gjithnjë e më shumë në rritje duke arritur pikën kritike në vitin 2016 me emigrimin në masë të gjerë të shqiptarëve kryesisht në Gjermani.


Tabela 1: Shpërndarja e emigrantëve shqiptarë sipas destinacioneve kryesore, 1995 – 2019

Viti	1995	2000	2005	2010	2015	2019
Itali	31,9%	33,3%	37,4%	39,3%	39,6%	39,4%
Greqi	45,9%	48,6%	43,8%	41,5%	38,7%	35,3%
ShBA	4,5%	4,8%	5,7%	6,4%	8,1%	8,2%
Gjermani	1,7%	1,4%	1,4%	1,3%	1,3%	4,2%
Kanada	0,7%	0,8%	1,0%	1,2%	1,4%	1,4%
Mbretëria e Bashkuar	0,2%	0,3%	0,8%	0,7%	0,9%	0,9%
Belgjikë	0,4%	0,3%	0,3%	0,5%	0,8%	0,9%
Vendet e tjera	14,8%	10,7%	9,7%	9,0%	9,2%	9,7%

Burimi: Stoku i emigrantëve (2019), Organizata e Kombeve të Bashkuara

Informacioni në tabelën 1, hedh dritë në lidhje me destinacionet kryesore të emigrantëve shqiptarë ndër vite, trendi i fillimit të viteve të demokracisë ishte kryesisht drejt vendeve kufitare si Greqi dhe Itali. Ky trend mund të themi që viteve të fundit është zbehur ku shqiptarët emigrant kanë zgjedhur destinacione të tjera krahas këtyre vendeve si psh. SHBA, Gjermani apo Kanada. Zgjedhja e vendeve me mirëqenie ekonomike dhe sociale vjen si rezultat të politikave lehtësuese në lidhje me emigrimin në këto vende.

Grafiku 4: Diaspora 1 Janar 2020 sipas grupmoshës dhe gjinisë



Burimi: Diaspora e Shqipërisë në Shifra, INSTAT (2020)


Grafiku 4, jep një informacion më të zgjeruar në lidhje me popullatën² e larguar nga Shqipëria deri më 1 Janar 2020. INSTAT ka vlerësuar në publikimin e tij “Diaspora e Shqipërisë në Shifra” numrin total të popullatës së larguar nga Shqipëria sipas grupmoshës dhe sipas gjinisë. Në total janë 1.684.135 individë jashtë territorit të Shqipërisë, ku 884.719 individë janë meshkuj dhe 799.416 janë femra. Gjithashtu, në kuadër të tematikës së migracionit, INSTAT dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ka kryer një anketë të migracionit në familje, objektivi kryesor i së cilës ishte ofrimi i informacionit për shkallën e migracionit neto për periudhën 2011-2019 dhe karakteristikat e popullsisë së përfshirë. Në këtë anketë u mbledhën të dhënat për nivelin arsimor dhe statusin e punësimit, në grupin e personave 15 vjeç e sipër. Personat me nivel të lartë arsimor mes emigrantëve dhe imigrantëve ishin përkatësisht 13,9 % dhe 11,9 %.³

Në grafikun 5, vërehet se përqindja e emigrantëve të nivelit të lartë arsimor është 47,1 % një shifër e lartë krahasuar me shpërndarjen në përqindje të personave që imigrojnë me 28,3 % dhe atyre brenda vendit me 24,6 %.

² Shih metodologjinë e ndjekur në publikimin Diaspora e Shqipërisë në Shifra, INSTAT (2020)

³ Shih: Anketa Kombëtare e Migracionit në familje në Shqipëri, 2020

Grafiku 5: Lloji i migracionit të grupmoshës 15 vjeç e lart sipas nivelit arsimor⁴, 2011-2019



Burimi: Anketa Kombëtare e Migracionit në familje në Shqipëri, INSTAT dhe IOM (2020)

5. POLITIKAT PËR TË “ZBUTUR” FENOMENIN E “IKJES SË TRURIT”

Duke qënë se fenomeni i “ikjes së trurit” është fenomen i derivuar nga globalizimi, mund të themi që përpjekjet për ta shmangur atë janë praktikisht të pamundura, megjithatë mund të bëhen përpjekje për ta “zbutur” efektin negativ të këtij fenomeni, kryesisht në vendet në zhvillim. Metoda më e rëndësishme është të ndërmerren një sërë politikash që përfshijnë aspekte të rëndësishme të zhvillimit të një vendi, si ai ekonomik, social, arsimor dhe mjedisor. E para dhe më e rëndësishmja, duhet të pranojmë që emigracioni i vazhdueshëm është zakonisht simptoma, jo shkak, i një problemi themelor. Për një periudhë afatgjatë, qeveritë duhet të adresojnë çështje themelore me politikën që synojnë përmirësimin e qeverisjes, forcimin e institucioneve dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Rritja e produktivitetit në profesionet që kërkojnë kualifikim të lartë, shumë prej të cilave janë në sektorin publik, dhe bërja e pagave më konkurruese, do të “joshte” punëtorët të qëndronin. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i sektorit privat dhe krijimi i vendeve të punës duhet të plotësohen me reformat e sektorit publik, pa të cilat, profesionistët të kualifikuar do të vazhdojnë të emigrojnë. Zgjerimi dhe përmirësimi i arsimit të lartë dhe atij pasuniversitar është një tjetër politikë kryesore që duhet ndërmarrë, pavarësisht shqetësimeve se kjo qasje mund të shkaktojë edhe më shumë emigracion, duke çuar në humbje të mëtejshme. Disa vende, përfshirë Rumaninë dhe Kroacinë, tashmë e kanë ndjekur këtë politikë për të mbajtur më shumë studentë në vendin e tyre të cilët aspironin për të shkuar jashtë vendit në kërkim të arsimit me cilësi më të lartë.

Gjithashtu një çështje kritike është dhe diskriminimi ndaj grave në tregun e punës. Migrantet femra me aftësi të larta profesionale aktualisht përfaqësojnë grupin me rritjen më të shpejtë midis të gjithë migrantëve në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore. Sigurimi i më shumë mundësive për gratë do të çonte natyrshëm në më pak emigrim të grave me aftësi të larta profesionale dhe do të ndihmonte vendet të ngadalësonin “ikjen e trurit”.

Një pjesë e rëndësishme e punës i adresohet dhe diasporës. Një diasporë e madhe mund të gjenerojë përfitime ekonomike për vendet e origjinës. Emigrantët që qëndrojnë të angazhuar në mënyrë aktive me vendet e tyre të origjinës mund të kenë një ndikim pozitiv në komunitetet e tyre përmes remitancave, investimeve dhe transferimit të teknologjisë.

Ekzistojnë gjithashtu politika që mund të inkurajojnë me sukses kthimin e diasporës së tyre me aftësi të larta profesionale duke siguruar stimuj tatimor për emigrantët e kthyer. Kthimi i migrantëve mund të mbështesë zhvillimin ekonomik, veçanërisht kur ata sjellin kapital dhe njohuri, dhe kur vendet e tyre u japin kushtet e duhura atyre për të vënë në zbatim plotësisht aftësitë dhe përvojën e tyre.

Dhe në përfundim të kësaj çështje mund të theksojmë se qasja më efektive afatgjatë për vendet, për të ndaluar ikjen e trurit është në radhë të parë dekurajimi i qytetarëve të largohen nga vendi i tyre, duke u dhënë atyre një arsye për të qëndruar - kjo do të thotë sigurim i vendeve me kushte më të mira pune, më shumë mundësi dhe një standard më të lartë jetese.

⁴ Sqarim mbi kategorizimin e nivelit arsimor:

i. Arsimit i ulët përfshin: Pa arsim, Arsim fillor dhe Arsim i ulët i mesëm (7/8/9 vjet);
ii. Arsimit i mesëm përfshin: Shkollë profesionale, Gjimnaz (shkollë e mesme) dhe Arsim post-sekondar dhe jo i lartë
iii. Arsimit i lartë përfshin: Bachelor, Master dhe Doktoraturë.

6. KONKLUZIONE

Në përmbyllje të këtij artikulli theksojmë se fenomeni i “ikjes së trurit” është si pasojë e globalizimit dhe detyrimisht është i pashmangshëm. Ky fenomen nuk duhet parë vetëm në anën e tij “më të errët”, por mund të shikohet dhe ana tjetër e medaljes duke e kthyer atë në avantazh. Kthimi i fenomenit të “ikjes së trurit” në avantazh konkurrues mund të behët më anë të politikave të duhura nxitëse.

Ky fenomen ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të një vendi dhe është një faktor kyç në rritjen ekonomike kryesisht në vendet në zhvillim, ku gjithmonë ka patur disa valë migratore në periudha të ndryshme historike. Megjithatë, në thelb vendimi për të emigruar është një vendim shumë personal i individëve, të cilët janë në kërkim të mundësive të reja dhe një standardi më të lartë jetese.

Një ndër konkluzionet e arritura në këtë artikull është që numri i studentëve shqiptar që studiojnë jashtë krahasuar me shtetet e tjera të rajonit është më i larti. Ky fakt derivon në faktin tjetër që fenomeni i “ikjes së trurit” në krahasim me vendet e tjera të rajonit është më i evidentueshëm në Shqipëri dhe kjo situatë kërkon politika të menjëhershme, shumë vizionare që studentët shqiptar të mirë-arsimuar të rikthehen dhe të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të vendit tonë.

Një mjedis më i sigurt, me një treg pune konkurrues, me paga më të larta, një vend me baza të forta meritokracie, me një nivel arsimit cilësor dhe konkurrues me vendet e tjera të Europës, me një zhvillim teknologjik të përshtatshëm për kohën kur jetojmë dhe shanset e barabarta për të gjithë do sigurojnë jo vetëm uljen e nivelit të migrimit dhe rikthimin e studentëve në vendin e origjinës, por mbi të gjitha do të sigurojnë një standard më të lartë jetese dhe një ekonomi me rritje të vazhdueshme pozitive, duke përbushur qëllimin kryesor që duhet të ketë një vend për rritjen e mirëqënies së qytetarëve të saj.

REFERENCA

1. Brzozowski, J. (2008), “Brain Drain or Brain Gain? The New Economics of Brain Drain Reconsidered”, Cracow University of Economics.
<file:///C:/Users/User/Downloads/SSRN-id1288043.pdf>
2. Diaspora e Shqipërisë në Shifra, INSTAT 2020
<http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2020/diaspora-n%C3%AB-shifra-2020>
3. Gëdeshi, I. dhe King, R. (2018), “New Trends in Potential Migration from Albania”, CESS dhe Friedrich Ebert Foundation.
<http://library.fes.de/pdf files/bueros/albanien/15272.pdf>
4. Giannoccolo, P. (2004), “The Brain Drain. A Survey of the Literature”, Department of Economics, University of Bologna, Italy
<http://amsacta.unibo.it/1577/1/526.pdf>
5. Gibson, J and McKenzie, D. (2010), “The Economic Consequences of ‘Brain Drain’ of the Best and Brightest: Microeconomic Evidence from Five Countries”, World Bank Policy Research Working Paper No. 5394.
https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1653198
6. Global Flow of Tertiary-Level Students
<http://uis.unesco.org/en/uis-student-flow>
7. Groizard, J.L. (2007), “Skilled migration and sending economies. Testing brain drain and brain gain theories”, Universitat de les Illes Balears, Department of Applied Economics.
<http://pareto.uab.cat/jllull/Papers/BrainDrain.pdf>
8. Inayati, T. (2012), “Simulation analysis of brain drain phenomena from Indonesia using system dynamics”, International Journal of BRIC Business Research (IJBBR).
https://www.academia.edu/36215108/SIMULATION_ANALYSIS_OF_BRAIN_DRAIN_PHENOMENA_FROM_INDONESIA_USING_SYSTEM_DYNAMICS
9. Johnson, N. (2008-2009), “Analysis and Assessment of the ‘Brain Drain, Florida Atlantic Comparative Studies Journal Vol. 11.
<https://home.fau.edu/peralta/web/FACS/braindrain.pdf>
10. Nedeljkovic, V. (2014), “Brain Drain in the European Union: Facts and Figures”, BiddingEurope Rethink Education Working Paper, No.4.
11. Ngjela, J. (2019), “Migrimi evropian në kuadrin e proceseve modernizuese (Rasti i Shqipërisë pas viteve 1990 – 2015)”, Doktoraturë, Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane.
<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wpcontent/uploads/2019/04/Doktoratura-Juventina-Ngjela-PDF.pdf>
12. Organizata e Kombeve të Bashkuara (2019), “International migrant stock 2019”. <https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/data/estimates2/estimates19.asp>
13. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin dhe INSTAT (2020), “Anketa Kombëtare e Migracionit në familje në Shqipëri”, fq. 43
[Zhvillimi_i_anketes_kombetare_të_migracionit_në_familje_ALB.pdf](http://zhvillimi_i_anketes_kombetare_të_migracionit_në_familje_ALB.pdf) (iom.int)
14. Pănescu, C. U. (2004), “Brain Drain and Brain Gain: A New Perspective on Highly Skilled Migration”, Diplomatic Academy, Ministry of Foreign Affairs, Bucharest.

15. Schiff, M. (2005), “Brain Gain: Claims about Its Size and Impact on Welfare and Growth Are Greatly Exaggerated”, IZA Institute of Labor Economics.
<https://www.iza.org/publications/dp/1599/brain-gain-claims-about-its-size-and-impact-on-welfare-and-growth-are-greatly-exaggerated>
16. World Bank (2016a), “South-East Europe Regular Economic Report”, No. 10, Resilient Growth and Rising Risks, Washington DC.
17. World Bank (2016b), “Migration and Remittances Factbook 2016”, Washington DC.
18. World Bank (2018), “Higher but Fragile Growth. Western Balkans Regular Economic Report”, No.14. Washington DC.

NON-RESPONSE ADJUSTMENT AND REVISION OF TIME SERIES IN WASTE STATISTICS*

Jovana Mihailovic, Statistical Office of Montenegro – MONSTAT
jovana.mihailovic@monstat.org

Abstrakt

Suksesi i një vrojtimi varet, ndër të tjera, nga shkalla e përgjigjes. Mali i Zi është një vend me një ekonomi të vogël, por një treg dinamik dhe i orientuar nga konsumatorët. Numëri i madh i vrojtime dhe kërkesave e rregulloreve të BE çojnë në një ngarkesë në rritje për njësitë e përgjigjura, e cila rezulton në pakënaqësi dhe refuzimin për të bashkëpunuar nga ana e bizneseve. Ky punim përshkruan zhvillimin e metodologjisë së vrojtimeve në statistikat e mbetjeve në Malin e Zi, duke përfshirë trajtimin e mos-përgjigjeve si edhe përshtatjet për të eliminuar efektet e mos-përgjigjeve. Në mënyrë që të merren të dhëna cilësore gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme pas aplikimit të metodës së imputimit dhe përgjithësimit për përshtatjen e mos përgjigjes, është bërë rishikimi i serive kohore. Rishikimi i serive kohore për periudhën 2011-2015 në statistikat e mbetjeve në Malin e Zi është paraqitur në këtë artikull.

Abstract

The success of the survey depends, among other things, on the response rate. Montenegro is a country with a small but dynamic and market-oriented economy. Large number of surveys and requirements of EU regulations leads to an increasing burden on response units, which results in dissatisfaction with business entities and the refusal to cooperate. This paper describes development of survey methodology in waste statistics in Montenegro, including dealing with non-response and non-response adjustment. In order to obtain quality comprehensive and comparable data after applying imputation and weighting method for non-response adjusting, revision of time series was done. Revision of time series for period 2011-2015 in waste statistics in Montenegro is presented in this paper.

**Autor i huaj. Artikulli është vetëm në anglisht.*

Keywords:

Waste statistics in business sectors, dealing with non-response, revision of time series

1. INTRODUCTION

Montenegro is a country with an economy based on small and medium enterprises that generate more than half of the GDP. In 2020, the Statistical Business Register contained around 37 000 units. The share of small enterprises with less than 50 employees in the total number of enterprises was 99.3%. In line with EU Regulations, these units are covered with large number of statistical surveys and one enterprise often ends up in a large number of survey samples. In many surveys, this leads to dissatisfaction of reporting units and a refusal to cooperate. The official statistical system of Montenegro and the implementation of operational objectives are based on the principles of the European Statistics Code of Practice, which are fully incorporated into the Law on Official Statistics. Therefore, in order to obtain quality comprehensive data, statisticians have to find methods to minimize effects of some errors such as errors due to non-response. This applies to waste statistics as well. Namely, waste statistics have been evolving over many years. At the beginning, in the phase of developing waste statistic surveys, the problem of high non-response was encountered in the survey on generated waste from industry. This problem was solved by introducing imputation and weighting method in 2014. Together with weighting for non-response and data control (between years, between surveys and between waste types) the method of calculation of results changed and it was necessary to recalculate the time series.

2. WASTE STATISTICS

2.1 Development of waste statistics in Montenegro

As an Ecological State, Montenegro wants to implement a modern waste management system in order to reduce the negative impact of waste on the environment by increasing the economic benefits of waste management and the transformation of waste into a resource. Waste management is one of the most demanding areas in terms of harmonization with European Union standards and one of the preconditions for joining the EU. The aim of waste statistics surveys is to obtain data on generated and treated waste in Montenegro, on cross-border movement of waste (import, transit and export), deposited quantities of waste and waste recycling rates.

Waste statistics in Montenegro began to develop in 2006 and related mainly to the assessment of data on the quantities of municipal waste collected by utility companies, including data on utility equipment and machinery. At the beginning of 2013, a system for calculating the generated quantities of municipal waste was established based on data on the number of inhabitants by municipalities. The quantities of municipal waste were determined for the population that is not served by public waste disposal services.

From 2014, a system for the development of structural indicators in line with international rules, i.e. the Regulation on Waste Statistics (Regulation EC No 2150/2002) was established. In accordance with the requirements of Regulation in the field of waste statistics, the following data are produced:

- on generated waste by waste categories and economic activities (NACE Rev.2)
- on treated waste by waste categories and economic activities (NACE Rev.2)
- on the number and capacities of waste treatment plants and the population served by the waste collection scheme
- on structural indicators.

2.2 Statistical surveys on waste statistics in business sectors

The Environmental Statistics and Forestry Department in MONSTAT is responsible for conducting surveys on types and source of waste generated by households and business entities involved in production or services activities. Surveys on waste statistics in business sectors covering industry, agriculture, construction and services, were developed individually from 2011 to 2015. The Statistical Survey on Generated Waste was conducted for the first time in 2011 for the sector Industry. The results were based on the obtained data with presence of non-response and without applying other quality control methods, because there were no conditions for using administrative sources. Data on generated waste and waste treatment in Montenegro are produced by conducting the following surveys:

- Survey on Industrial Waste
- Survey on Generated Waste in Agriculture
- Survey on Generated Waste in Construction Sector
- Survey on Generated Waste in Service Activities

In the period 2011-2015, these surveys were created, but at the same time, the existing survey methodologies were improved.

At the same time institutional capacities in Montenegro were developed, providing numerous registers and records on issued permits. It is important to mention legal acts on the Environment: Law on Waste Management (2008), National Waste Management Plan (2011), Ordinance on Waste Classification (2008) and Waste Catalog (2013).

3. SURVEY METHODOLOGY

The surveys on generated waste and waste treatment include all business entities with 10 or more employees, with main activity in almost all sectors of the National Classification of Activities 2010. The National Classification of Activities 2010 is based on Nace Rev.2 classification and includes all economic activities that can be performed on the territory of Montenegro and is used for the collection, entry, processing, publication and dissemination of statistical data. In conducting of all surveys in the field of waste statistics, the reporting method of data collection was applied, and from the geographical aspect, business entities that perform their production activities on the entire territory of Montenegro are included. Data collection method is based on The Rulebook on Waste Catalogue and Waste Classification (Official Gazette of Montenegro, No. 59/13 of 26 December 2013), which is harmonized with the European Waste List (LoW) and contains more than 800 types of waste systematized according to properties and place of origin in 20 groups. Of these 20 groups, most are based on the activities in which the waste is generated, while some groups are based on materials or processes.

4. NON-RESPONSE

4.1 Reducing non-response

As waste statistics developed gradually, so did the awareness of enterprises to provide the data in this area. At the beginning of the survey, non-response rate was high, especially when the pilot surveys were conducted. At that time, attempts were made to reduce non-response rate and obtain quality data. The first step was to analyze enterprises in target population. The List of reporting units was revised by keeping enterprises that generated certain types of waste, because remain units had only municipal waste and those data were already collected in another survey.

